

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7148
E premte, 22 mars 2024
Çmimi 0.50

Bideni fal edhe 6 miliardë dollarë kredi studentore



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

NDIHMËSSEKRETARI AMERIKAN I BYROSË NDËRKOMBËTARE TË NARKOTIKËVE DHE ÇËSHTJEVE TË ZBATIMIT TË LIGJIT, TODD ROBINSON, VIZITON KOSOVËN

MBËSHTETJA E PALËKUNDUR E SHBA-së, THELBËSORE PËR SUKSESET E KOSOVËS NË FUSHËN E SUNDIMIT TË LIGJIT



Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka takuar të enjten në Prishtinë ndihmësekretarin amerikan të Byrosë Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit,

Todd Robinson. Osmani ka njoftuar se janë pajtuar ta vazhdojnë punën drejt arritjes së qëllimit të përbashkët: luftimin e krimit të organizuar transnacional me qëllim të garantimit të sigurisë

për të gjithë qytetarët tanë. Ndërkaq ndihmësekretari Robinson ka theksuar se ShBA-ja mbështet Kosovën që t'i përmirësojë strukturat gjyqësore dhe të sigurisë

AKTUALE



PËRFUNDON KONFERENCA E 'JAVËS SË GRUAS 2024', THEKSOHET NEVOJA PËR QEVERISJE GJITHËPËRFSHIRËSE

EMISARI GJERMAN TAKOHET ME KURTIN, BISEDONJË PËR PROCESIN E BERLINIT

ZYRTARI I NATO-s VIZITON KIEVIN, BËN THIRRJE PËR MBËSHTETJE TË FORTË

EKONOMI



"BQK-ja ANGAZHONET DHE MBËSHTET NISMAT QË GRATË TË KENË PËRFSHIRJE FINANCIARE"


AEROPORTI I PRISHTINËS DO TË KOMPENSOHET PËR PERIUdhËN E PANDEMISË, TARIFA E KONCESIONIMIT RRITET NË 55 PËR QIND

SPORT



KOSOVA SOT PËRBALLET ME ARMENINË, FODA DHE MURIQI PARALAJMËROJNË FITORE

ME A PA RRITJE? NË PRITJE TË FATURAVE TË REJA TË RRYMËS



HOXHAJ: VIZITA E DAÇIQIT NË RUSI ËSHTË ALARMANTE PËR BALLKANIN



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mobi: +377 44 501 289
E-mail: renovamt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Bideni fal edhe 6 miliardë dollarë kredi studentore

WASHINGTON, 21 MARS - Presidenti amerikan Joe Biden njoftoi se 6 miliardë dollarë kredi studentore do të anulohen për 78 000 persona. Me këtë, vlera e përgjithshme e kredive studentore të anuluar nga administrata Biden arrin në pothuajse 150 miliardë dollarë. Demokrati Biden vitin e kaluar u zotua se do të gjente mënyra të tjera për ta lehtësuar borxhin pasi Gjykata Supreme në qershor bllokoj planin e tij të gjerë për anulimin e 430 miliardë dollarëve në kredi studentore. Në grupin e fundit të personave që u janë anuluar kreditë studentore janë punëtorët në shërbimet publike sikurse mësuesit, infermierët dhe zjarrfikësit të cilët kanë plotësuar kriteret e Programit për Faljen e Kredive të Shërbimit Publik të



krijuar më 2007 me qëllim që të amerikanëve që punojnë në falen kreditë studentore të shërbimit publik. "Këta

punëtorë të shërbimit publik kanë vendosur që në karrierën e tyre t'u shërbejnë komuniteteve të tyre, por për shkak të dështimeve të administratave të kaluara, nuk u ndihmuan ashtu siç e parasheh ligji", tha Bideni përmes një deklarate.

Deri në qershor të vitit 2023 afër 43.4 milionë marrës të kredive studentore në ShBA kishin një borxh të përbashkët në vlerë prej 1.63 trilion dollarësh, sipas uebfaqes për Ndihmë të Studentëve Federalë. Kreditë për edukim të lartë janë trefishuar që nga kriza financiare e vitit 2008.

Normat e larta të interesit dhe kështu e larta nënkuptojnë se të rinjtë amerikanë kanë vështirësi që të blejnë shtëpi apo të bëjnë investime të tjera dhe demokratët për vite të tëra i

kishin bërë presion qeverisë amerikane që t'i falte këto kredi. Republikanët i kundërshtojnë këto politika.

Bideni po kërkon të fitojë një mandat të dytë gjatë zgjedhjeve presidenciale të nëntorit dhe për këtë ka nevojë t'i fitojë votat e të rinjve. "Nuk do të dorëzohem dhe do t'i përdor të gjitha mjetet që kam në dispozicion që sa më shumë amerikanëve t'ua lehtësoj barrën e kredive studentore dhe të ndërtoj një ekonomi të fortë", tha Bideni.

Një zyrtar i Shtëpisë së Bardhë tha se vendimi i fundit i Bidenit ka bërë që shifra e përgjithshme e faljes së kredive studentore në administratën Biden të arrijë në 144 miliardë dollarë dhe kreditë studentore u janë falur pothuajse 4 milionë amerikanëve.

Kina dërgon dhjetëra avionë luftarakë mbi Tajvan

PEKIN, 21 MARS - Ministria e Mbrojtjes e Tajvanit tha se 32 avionë luftarakë të ushtrisë kineze janë detektuar përreth ishullit në 24 orët e fundit. Ky është numri i dytë më i lartë i fluturakeve kineze të detektuara mbi ishullin vetëqeverisës gjatë këtij viti.

Ministria e Mbrojtjes Kombëtare të Tajvanit, po ashtu, tha se në 24 orët e fundit janë detektuar edhe pesë anije të Marinës së Kinës përreth Tajvanit.

Trembëdhjetë avionë "kanë kaluar vijën e mesme në Ngushticën e Tajvanit", u shtua në deklaratë.

Kjo vijë është kufiri jozyrtar mes Kinës dhe Tajvanit.

Forcat e armatosura të Tajvanit kanë "monitoruar situatën dhe dislokuan një avion patrullues, anije të Marinës, dhe sisteme të mbrojtjes raketore si përgjigje ndaj aktiviteteve të detektuara".

Në fund të janarit dhe në fillim të shkurtit, kjo ministri kishte detektuar 33 avionë luftarakë kinezë rreth ishullit - numër rekord i avionëve të detektuar gjatë këtij viti.

Detektimi i këtyre avionëve pasoi zgjedhjet presidenciale të 13 janarit, të cilat i fitoi zëvendës-presidenti aktual, Lai Ching-te, të cilin Pekini e kundërshton.

Muajin e kaluar, Tajvani tha se 11 luftanije kineze u detektuan përreth ishullit - numri më i madh gjatë këtij viti teksa Tajpei dhe Pekini u përplasën rreth një incidenti vdekjeprurës të një anijeje peshkimi. Anija kineze e peshkimit, me katër persona në bord, u fundos më 14 shkurt afër Tajvanit, teksa po ndiqej nga rojet bregdetare tajvaneze. Gjatë këtij incidenti, dy persona u vranë dhe dy të tjerë shpëtuan.

Ky incident ndodhi në kohën kur tensionet mes Kinës dhe



Tajvanit janë të larta. Kina e konsideron Tajvanin

pjesë të saj dhe nuk e përjashton mundësinë që një ditë të marrë

kontrollin e tij, qoftë edhe me forcë.

Zyrtari i NATO-s viziton Kievin, bën thirrje për mbështetje të fortë

KIEV, 21 MARS - Shefi i komitetit ushtarak të NATO-s, Rob Bauer, gjatë vizitës në Kiev deklaroi se aleatët e Ukrainës nuk duhet të jenë pesimistë lidhur me aftësinë e shtetit për të zbrapsur trupat ruse dhe bëri thirrje që paketat e rëndësishme të ndihmës të dërgohet me shpejtësi.

Bauer udhëhoqi vizitën e parë zyrtare në Kiev të një delegacioni ushtarak të NATO-s që nga shkurti i vitit 2022, kur Rusia nisi pushtimin në shkallë të gjerë të Ukrainës.

Trupat e Kievit po përballen me mungesë të municioneve dhe të ushtarëve dhe po përballen me




forcat ruse në lindje, të cilat po avancojnë. "Ukrainës i duhet edhe më shumë mbështetje. Dhe ju duhet tani. Koha në Ukrainë nuk matet në ditë, javë apo muaj. Matet me jetën e njerëzve. Në shtetet e aleatëve java është javë. Në Ukrainë, një javë është një nënë, baba, fëmijë, mik, i dashur, që humb përgjithmonë", tha ai në Forumin e Sigurisë së Kievit.

Ai lavdëroi qëndrueshmërinë e Kievit dhe aftësinë për t'u përshtatur shpejt me shumë aspekte të luftimeve moderne. Bauer, po ashtu, u takua me shefin e ushtrisë ukrainase, Oleksandr Syrskyi, me të cilin bisedoi për

situatën aktuale të luftimeve. Syrskyi shkroi në Facebook se gjatë takimit është biseduar për furnizimet me municione dhe për mbrojtjen ajrore.

Me ministrin e Jashtëm ukrainas, Dmytro Kuleba, Bauer bisedoi për mundësinë e trajnimit të ushtarëve ukrainas dhe për bashkëpunimin në mes të industrive të mbrojtjes. "Përderisa bota mund të ketë qenë tepër optimiste më 2023, ne nuk duhet të bëjmë gabimin e njëjtë dhe të bëhemi tepër pesimistë më 2024", tha Bauer në Forumin e Sigurisë, duke shprehur besimin në aftësinë e Ukrainës që të ngadhënjë në fushëbetejë.

Me a pa rritje? Në pritje të faturave të reja të rrymës



Prishtinë, 21 mars - Faturat e rrymës në Kosovë mund të shtrenjtohen... edhe këtë vit. Mundësia tanimë i ka shqetësuar disa qytetarë. "Çdo ngritje e çmimit të shërbimeve do të nënkuptonte më pak produkte ushqimore, sepse ato të luksit i kemi harruar", thotë për Radion Evropa e Lirë, Bashkim Misini, punonjës në sektorin privat. "Katastrofë për ata që nuk kanë. Paratë e pensionit nuk po mjaftojnë as për ushqime e lëre më për rrymë e mbeturina", thotë pensionistja Mihane Berisha. Tash për tash vetëm Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) ka propozuar rritjen e çmimit të energjisë së prodhuar. Për tarifën që duhet t'i paguajnë qytetarët vendos Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) deri më 1 prill, por njohësit e fushës thonë se nëse rritet çmimi i energjisë së prodhuar, mund të rriten edhe këto tarifa.

Çfarë kërkoi KEK-u?

KEK-u konfirmoi për Radion Evropa e Lirë se ka propozuar rritjen e çmimit të energjisë së prodhuar. Dy termocentralet e kësaj korporate, Kosova A dhe Kosova B, prodhojnë sasinë më të madhe të energjisë, të nevojshme për

plotësimin e nevojave në vend. Kjo energji më pas i shitet KESCO-s, kompanisë përgjegjëse për furnizim dhe inkasim.

Në deklaratën me shkrim dhënë REL-it, KEK-u tha se marrëveshja e fundit mes tij dhe KESCO-s ka qenë e lidhur për periudhën "1 prill 2023 deri më 31 mars 2024". KEK-u tha se kërkesa është që çmimi të rritet nga 29.50 euro sa kushton aktualisht një megavat në orë, në 31.50 euro.

KEK-u tha se nuk ka informata nëse propozimi i tij është miratuar. Radio Evropa e Lirë e kontaktoi KESCO-n, por nuk mori përgjigje. KEK-u, po ashtu, nuk tregoi se përse ka kërkuar rritjen e çmimit, por në komentet që ia ka dërguar ZRRE-së e që i ka parë Radio Evropa e Lirë, korporata thirret në rritjen e koston së prodhimit dhe të inflacionit.

Për këtë thuhet se ka inkurajuar ZRRE-në që në të hyrat e KESCO-s të përfshihet edhe kostoja e blerjes së energjisë nga KEK-u. ZRRE-ja nuk iu përgjigj pyetjes së REL-it se a do të ketë rritje të tarifave të energjisë elektrike, por tha se është "në proces të analizimit dhe shqyrtimit të komenteve të dërguara nga palët e interesuara".

ZRRE-ja bën shqyrtimin dhe caktimin e përvitshëm të tarifave, të cilat shpallen çdo 1 prill.

Vitin e kaluar, tarifën u rritën për 15 për qind për të gjitha kategoritë e konsumatorëve.

Për konsumatorët që shpenzojnë deri në 800 kilovatë në orë brenda një muaji, çmimi gjatë ditës është 7.79 centë për kilovat, ndërsa për ata që shpenzojnë më shumë se 800 kilovatë, pjesa mbi këtë u llogaritet me çmim prej 14.45 centësh.

Nga ora 22:00 deri në 7:00 të mëngjesit, çmimi për kilovat është 3.34 centë për ata që shpenzojnë deri në 800 kilovatë dhe 6.81 centë për atë që shpenzojnë më shumë.

Çfarë thonë ekspertët?

Fadil Ismaili, ish-ministër i Zhvillimit Ekonomik të Kosovës, thotë se rritja e çmimit të energjisë së prodhuar elektrike mund të pasohet me shtrenjtimitin e rrymës që paguajnë qytetarët. Megjithatë, ai thotë se kërkesa e KEK-ut është e justifikueshme. "Energjia elektrike është një mall sikurse çdo mall tjetër. Në një kilovat të prodhimit të energjisë elektrike, nevojitet shpenzim i naftës, thëngjillit, mirëmbajtje... Kështu, edhe çmimi i energjisë elektrike mund t'i nënshtrohet ngritjes së çmimeve të produkteve dhe shërbimeve të tjera", thotë Ismaili për Radion

Evropa e Lirë.

Ai shton se, nëse kjo ndodh, efekti zinxhiror do të jetë i pashmangshëm, pasi "çdo ndryshim i tarifave të rrymës ndikon edhe në koston e biznesit, sidomos tek industria prodhuese, duke i rritur çmimet e artikujve tjerë".

Skender Krasniqi, kryetar i Bordit Drejtues të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë në Prishtinë, e justifikon po ashtu kërkesën e KEK-ut, por thotë se ZRRE-ja nuk duhet të lejojë që ajo të reflektohet në faturat e qytetarëve.

Nëse rritet çmimi i rrymës, thotë ai, disa biznese prodhuese edhe mund të mbyllen dhe kompanitë tjera, pastaj, i rrisin çmimet. "Nëse kjo ndodh, nevojitet mbështetje financiare nga Qeveria për bizneset... sepse kjo do të ishte e papërballueshme për disa", thotë Krasniqi për Radion Evropa e Lirë. Çmimet e energjisë, gjetiu në botë, kanë nisur të marrin hov në fillim të vitit 2022, kur Rusia ka nisur pushtimin e Ukrainës dhe inflacioni ka nisur, po ashtu, të rritet me shpejtësi.

Për rrjedhojë, Qeveria e Kosovës ka ndarë në disa raste subvencione. Në një periudhë, ajo i ka subvencionuar konsumatorët që kanë kursyer së paku 5 për qind të rrymës në muaj, krahasuar me muajin e

njëjtë të vitit paraprak. Këta konsumatorë kanë përfituar dyfishin e përqindjes së kursyer.

Shtrenjtohen edhe faturat e mbeturinave

Pas tetë vjetësh ndryshime në shkurt të këtij viti pësuan edhe faturat e mbeturinave. Zyrtarë të Kompanisë Rajonale "Pastrimi" konfirmuan për Radion Evropa e Lirë se për klientët e amvisërisë faturat u rritën nga 4.70 në 6.20 euro, kurse për bizneset e vogla dhe të mesme, faturat u shtrenjtuan për 2, respektivisht 3 euro.

Kompania "Pastrimi", përveç në komunën e Prishtinës, operon edhe në komunën e Fushë-Kosovës, të Obiliqit, Lipjanit, Drenasit dhe Podujevës.

Zëdhënësja Arbnora Ademi thotë për Radion Evropa e Lirë se nga inflacioni i viteve të fundit është atakuar edhe kompania "Pastrimi", duke përmendur shtrenjtimitin e derivateve të naftës dhe makinerive të ndryshme për grumbullimin dhe deponimin e mbeturinave. "Gjithçka është shtrenjtuar. Tmerr, tmerr...", thotë pensionistja Mihane Berisha, e cila jeton me bashkëshortin në Prishtinë dhe të dy marrin 200 euro në muaj pensione.

Emisari gjerman takohet me Kurtin, bisedojnë për Procesin e Berlinit

PRISHTINË, 21 MARS - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, u prit nga përfaqësuesi i Posaçëm i Gjermanisë për Ballkanin Perëndimor, Manuel Sarrazin, në një mëngjes pune në rezidencën e ambasadorit të Gjermanisë në Kosovë, Jorn Rohde. Bashkëpunimi rajonal dhe integrimi ekonomik mes vendeve të Ballkanit Perëndimor në kuadër të Procesit të Berlinit si dhe

përgatitjet për Samitin e radhës të Procesit të Berlinit i cili këtë vit shënon dhjetëvjetorin e tij, ishin temë qendrore e diskutimit.

Kryeministri e falënderoi Sarrazin për bashkëpunimin e mirë, kontributin dhe rolin e tij për forcimin e marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Gjermanisë si dhe për avancimin e bashkëpunimit rajonal.

Kryeministri theksoi se Republika e Kosovës është e përkushtuar dhe interesuar për fqinjësi të mirë, avancim demokratik dhe progres socio-ekonomik në rajon ku qytetarët janë përfituesit përfundimtarë dhe shtoi rëndësinë e zbatimit të shpejtë dhe të plotë të marrëveshjeve që janë arritur në Procesin e Berlinit e të cilat rritin mobilitetin e qytetarëve dhe mundësitë për zhvillim.



NDIHMËSSEKRETARI AMERIKAN I BYROSË NDËRKOMBËTARE TË NARKOTIKËVE DHE ÇËSHTJEVE TË ZBATIMIT TË LIGJIT, TODD ROBINSON, VIZITON KOSOVËN

Mbështetja e palëkundur e ShBA-së, thelbësore për sukseset e Kosovës në fushën e sundimit të ligjit

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka takuar të enjten në Prishtinë ndihmëssekretarin amerikan të Byrosë Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit, Todd Robinson. Osmani ka njoftuar se janë pajtuar ta vazhdojnë punën drejt arritjes së qëllimit të përbashkët: luftimin e krimit të organizuar transnacional me qëllim të garantimit të sigurisë për të gjithë qytetarët tanë. Ndërkaq ndihmëssekretari Robinson ka theksuar se ShBA-ja mbështet Kosovën që t'i përmirësojë strukturat gjyqësore dhe të sigurisë

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

Prishtinë, 21 mars - Anëtarësimi i Kosovës në Organizatën Ndërkombëtare të Policisë (Interpol) është i pamundur pa mbështetjen e vazhdueshme të Shteteve të Bashkuara, tha presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, të enjten, pas takimit në Prishtinë me ndihmëssekretarin amerikan të Byrosë Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit, Todd Robinson. Sipas saj, anëtarësimi në Interpol do t'i rriste kapacitetet e Kosovës në mënyrë që institucionet ta përmirësonin përgjigjen "ndaj krimit dhe duke fuqizuar angazhimin tonë në drejtim të sigurisë publike për secilin qytetar të Republikës sonë". "Të vetmit që përfitojnë nga mosanëtarësimi i Kosovës në Interpol janë kriminelët, në veçanti grupet kriminale transnacionale. Është dëshirë dhe vullnet i përbashkët i

Kosovës dhe i ShBA-së që ata t'i luftojmë deri në fund dhe pa kompromis", ka thënë Osmani. Kosova ka nisur përpjekjet që të anëtarësohet në Interpol që nga viti 2010, por atëbotë kërkesa e saj nuk ishte marrë parasysh nga Komiteti Ekzekutiv i kësaj organizate. Më 2015 dhe 2016 Kosova s'arriti të futej në agjendën e Asamblesë së Përgjithshme të Interpolit, ndërkaq në vitet pasuese Prishtina nuk ka tentuar të anëtarësohet për shkak të mungesës së mbështetjes së mjaftueshme.

Presidentja Osmani falënderoi Byronë Amerikane të Narkotikëve dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit për mbështetjen dhe tha se ky institucion ka ndihmuar në themelimin e shumë institucioneve në Kosovë, përfshirë Policinë e Kosovës dhe Agjencinë e Forenzikës. "Mbështetja e ShBA-së për Kosovën ka qenë prezent në çdo sektor në çdo hap të shtetndërtimit", ka thënë Osmani, duke shtuar se mbështetja e

palëkundur e Shteteve të Bashkuara ka qenë thelbësore për sukseset e Kosovës në fushën e sundimit të ligjit.

Osmani ka theksuar se me Robinson u pajtuar ta vazhdojnë punën drejt arritjes së qëllimit të përbashkët: luftimin e krimit të organizuar transnacional me qëllim të garantimit të sigurisë për të gjithë qytetarët tanë.

Ndërkaq ndihmëssekretari Robinson tha se ShBA-ja e mbështet Kosovën që t'i përmirësojë strukturat gjyqësore dhe të sigurisë. "Fakti që jam këtu është për ta treguar mbështetjen për atë që po bëni ju, për atë që po

bën policia juaj, atë që po bëjnë shërbimet tuaja të sigurisë për qytetarët e thjeshtë të Kosovës. Mesazhi im për ta dhe për të gjithë ju është se ShBA-ja është këtu për t'i mbështetur përpjekjet tuaja për strukturat jetike të sigurisë dhe gjyqësorit. Ne po punojmë për një Kosovë më të mirë sot, po ashtu po punojmë për një Kosovë më transparente, më të fortë dhe më të sigurt nesër për qytetarët e Kosovës", ka thënë ai, duke shtuar se gjatë vizitës do të takohet me zyrtarë nga qeveria dhe nga sektori i drejtësisë.

Megjithatë, një takim me mes të kryeministrit të Kosovës, Albin

Kurti, dhe ndihmëssekretarit Robinson nuk është paralajmëruar nga ekzekutivi. Por, zyrtari amerikan pritet të takohet me zyrtarë të gjyqësorit.

Raportet në mes të qeverisë Kurti dhe qeverisë amerikane janë tendosur për shkak të vendimit të autoriteteve të Kosovës për të ndaluar dinari nserb të përdoret për pagesa në Kosovë. ShBA-ja po i kërkon Kosovës ta pezullojë zbatimin e vendimit të Bankës Qendrore të Kosovës, e cila parasheh euron valutën e vetme për kryerjen e pagesave. Por, qeveria Kurti nuk ka dhënë sinjale se do të tërhiqet nga ky vendim.

Hoxhaj: Vizita e Daçiçit në Rusi është alarmante për Ballkanin

Prishtinë, 21 mars - Ish-ministri i Jashtëm i Kosovës, Enver Hoxhaj, ka reaguar ndaj vizitës së ministrit të Jashtëm të Serbisë, Ivica Daçiç, në Moskë, duke u shprehur se është vizitë alarmante.

Hoxhaj në rrjetin social "X" ka thënë se Serbia i bën jehonë të kaluarës së Serbisë në vitet '90. Nënkrjetari i Kuvendit, Enver Hoxhaj, ka thënë se vendi kandidat për në BE, Serbia, është një trillim pasi ajo është bosht i gjenocideve kundër fqinjëve. "Vizita e ministrit të Jashtëm të Serbisë, Daçiç, në Moskë, në mes të luftës së Rusisë kundër Ukrainës dhe vlerave demokratike, është alarmante. Ajo i bën jehonë të kaluarës së Serbisë në vitet 1990. Vendi kandidat për në BE, Serbia është një trillim pasi ajo është bosht



i gjenocideve kundër fqinjëve të tyre. Të dyja vendet janë kundër një Ballkani demokratik dhe Ukrainës",

ka shkruar Hoxhaj. Daçiçi u takua me homologun e vet rus Sergei Lavrov të enjten në

Moskë, ku e falënderoi Rusinë për qëndrimin dhe mbështetjen e vendosur për Serbinë në lidhje me

integritetin territorial dhe sovranitetin e saj, si dhe për çështjen e Kosovës. "Për ne është me rëndësi jetike ta dimë se kemi një zë të sigurt në Këshillin e Sigurimit", ka thënë Daçiç.

Beogradi zyrtar llogarit në mbështetjen e Rusisë dhe të Kinës në organizatat dhe institucionet ndërkombëtare për mosnjohjen e Kosovës shtet i pavarur.

Serbia nuk e njeh pavarësinë e Kosovës, e shpallur në Prishtinë më 2008, por nga viti 2011 zhvillon dialog me të me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian për normalizim të marrëdhënieve fqinjësore.

Ministri i Jashtëm rus Lavrov tha para takimit se Rusia është e interesuar t'i "parandalojë krizat e reja" në Ballkan.

“BQK-ja angazhohet dhe mbështet nismat që gratë ndërmarrëse të kenë përfshirje financiare”

Prishtinë, 21 mars - Angazhimi i Bankës Qendrore të Kosovës në përfshirjen financiare të grave ndërmarrëse nuk është vetëm një objektivi, por është një investim në të ardhmen, ka deklaruar zëvendësguvernatorja për Funkcione të Përgjithshme, Nesrin Shileku-Shala, në konferencën “Qasja në financa për gratë ndërmarrëse”, e cila po bashkorganizohet nga BQK-ja dhe Asociacioni i Institucioneve Mikrofinanciare të Kosovës (AMIK) në kuadër të “Javës Ndërkombëtare të Parasë”.

Zëvendësguvernatorja Shileku-Shala në fjalën përshëndetëse theksoi se, me një qasje të shumanshme ndaj përfshirjes financiare, BQK-ja po kontribuon në një të ardhme më të ndritshme ekonomike për qytetarët e Republikës së Kosovës. “Banka Qendrore e Republikës së Kosovës në kuadër të mandatit të saj kushtetues e ligjor, dhe përmes strategjisë së saj, është e përkushtuar ta avancojë kornizën rregullative dhe infrastrukturën mbikëqyrëse me qëllim të harmonizimit me legjislacionin dhe politikën e Bashkimit Evropian dhe mbështetjes së nismave që rrisin qasjen në financa dhe qëndrueshmërinë”, ka thënë zëvendësguvernatorja Shileku-Shala në këtë konferencë.

Sipas zëvendësguvernatores Shileku-Shala, arritja e përfshirjes financiare dhe qasjes në financa



për gratë kërkon një përpjekje kolektive. “Sektori financiar, sidomos bankat, institucionet mikrofinanciare, por edhe institucionet financiare jobankare, ofrojnë mundësi, si dhe produkte e shërbime të cilat u dedikohen grave ndërmarrëse”, ka potencuar zëvendësguvernatorja Shileku-Shala.

Ajo ka shtuar se gratë ndërmarrëse kanë nevojë për më shumë trajnime dhe aktivitete në këtë drejtim nga aktorët e sektorit financiar dhe përtej. “Kontributi i institucioneve të sektorit financiar do të duhej të ishte më i madh në edukimin e grave sa i përket edukimit dhe trajnimit për

shërbimet dhe mundësitë financiare që do t'i rriste edhe portfolet respektive të institucioneve financiare dhe do të kontribuonte edhe në shëndetin e përgjithshëm financiar të sektorit”, ka shtuar ajo.

Në këtë drejtim, njohuria financiare si gurthemeli i fuqizimit financiar, grave ndërmarrëse do t'u mundësonte: T'i kuptojnë më mirë produktet dhe shërbimet e ndryshme financiare që tashmë janë në dispozicion; Të zhvillojnë plane të shëndosha biznesi dhe të menaxhojnë financat e tyre në mënyrë strategjike; Të negociojnë në mënyrë efektive me institucionet kredituese; dhe të

marrin vendime të informuara financiare për të siguruar suksesin afatgjatë të bizneseve të tyre.

Duke folur mbi adresimin e sfidave dhe pengesave që gratë ndërmarrëse përballen me bizneset e tyre, zëvendësguvernatorja për funksione të përgjithshme vuri në pah se BQK-ja përmes programeve të edukimit financiar do të kontribuojë në informimin dhe edukimin e tyre. “Banka Qendrore e Republikës së Kosovës do të inkurajojë projekte inovative, kampanja dhe programe të dedikuara në kuadër të fushës së edukimit financiar, me qëllim që të kontribuohet në eliminimin e

pengesave me të cilat përballen gratë ndërmarrëse çdo ditë në qasjen dhe përdorimin e shumëllojshmërisë së produkteve dhe shërbimeve financiare të cilat ofrohen në tregun vendor. Kjo është në linjë me objektivin e 5-të të Planit Strategjik të BQK-së”, vuri në pah zëvendësguvernatorja për funksione të përgjithshme e BQK-së.

Në fund, zëvendësguvernatorja Shileku-Shala tha se BQK-ja do të përkushtohet në mbledhjen dhe publikimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë për qasjen në financa, të dhëna këto që do të ofrojnë njohuri të vlefshme për sfidat specifike me të cilat përballen gratë ndërmarrëse në Republikën e Kosovës.

Java Ndërkombëtare e Parasë është një fushatë vjetore botërore ndërgjegjësuëse, e organizuar nga Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), e cila ka për qëllim që përmes aktiviteteve t'i informojë qytetarët që në moshë të hershme dhe gradualisht t'i fitojnë njohuritë, aftësitë, qëndrimet dhe sjelljet e nevojshme për të marrë vendime të shëndosha financiare dhe për ta arritur mirëqenien dhe qëndrueshmërinë financiare.

Sivjet është edicioni i 12-të i Javës Ndërkombëtare të Parasë që organizohet nga BQK-ja dhe motoja për këtë vit është “Kujdesi për paratë tua, siguro të ardhmen tënde”, krahas bankave qendrore në mbarë botën.

Dita Botërore e Sindromës Down, Kurti: Shteti dhe qeveria duhet të dëshmojnë më së shumti aty ku nevojat janë më të mëdha

PRISHTINË, 21 MARS - “Jam shumë i lumtur që po ju mirëpres që të gjithëve në Zyrën e Kryeministrit, në Ditën Botërore të Sindromës Down, që na bën neve edhe më të vetëdijshëm për përgjegjësinë që kemi për të ofruar kushte dhe qasje sa më të barabartë e të dinjitetshme për të gjithë pa lënë asnjëri prapa”, tha kryeministri Albin Kurti në takimin me disa nga të punësuarit nëpërmjet Masës 1.6. Mbështetja e Personave me Aftësi të Kufizuara. “Jam i lumtur që po ju pres si të punësuar dhe jam i interesuar të di më shumë për përvojat tuaja në vendet e punës që keni”, tha kryeministri.

Në takimin me Kurtin i ndanë përvojat e tyre në vendet e punës, si dhe të praktikës me arsimin dual: Vjosa Asllani, Hanife Raci, Genc Beqiri dhe Agron Bilalli.

U bisedua për punën që bëhet në pesë qendrat e Down Syndrome Kosova në Prishtinë, Prizren, Ferizaj,



Mitrovicë dhe Gjilan, ku përfitues të shërbimeve janë mbi 300 persona me sindromën down dhe aftësi të tjera të kufizuara intelektuale. “Për ne si shoqatë nuk ka qenë fare rrugëtim i lehtë për të arritur deri këtu. Kemi arritur bashkë me mbështetjen e institucioneve, miqve e bashkëpunëtorëve”, tha

Sebahate Hajdini-Beqiri, drejtoreshë ekzekutive e shoqatës Down Syndrome Kosova.

Kurti tha se shteti dhe qeveria duhet të dëshmojnë më së shumti e më së pari aty ku nevojat janë më të mëdha e mundësitë më të pakta. “Andaj, dëshirojmë që të bashkëbisedojmë se si mund të

bëjmë edhe më mirë dhe më shumë se deri më tani”, tha Kryeministri.

Ndërsa zëvendësministri i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, Agon Dobruna, ritheksoi përkushtimin e MFPT-së për mbështetje të mëtejme për jetësimin e të drejtave për personat

me sindromën down dhe ata me aftësi të kufizuara.

Në takim u theksua qëllimi i gjithëpërfshirjes dhe barazisë në edukim, për çfarë qeveria ka punësuar 250 asistentë për fëmijë me nevoja të veçanta në shkollë e deri në fund të mandatit planifikon t'i ketë 500.

U theksua se studimet janë bërë falas, janë ndarë bursa për 13 studente me aftësi të kufizuara, ndërsa nëpërmjet masës 1.6 Mbështetja e punësimit të personave me nevoja të veçanta janë punësuar 239 persona, prej tyre 119 burra dhe 120 gra.

Kurti falënderoi Down Syndrom Kosova për bashkëpunimin, kontributin edhe në formën e ideve dhe të aktiviteteve që zhvillon. “Më vjen mirë që jeni pjesë e zhvillimeve të politikave të Zyrës së Kryeministrit, përfshirë Strategjinë për personat me aftësi të kufizuara 2024-2029”, tha ai.

Përkujtohet dëshmori Bekim Hysenaj

PRISHTINË, 21 MARS - Me rastin e 25-vjetorit të rënies së dëshmorit Bekim Hysenaj, nënkryetari i komunës së Drenasit, Arben Shala, bashkë me bashkëpunëtorë, bënë homazhe pranë varrit

të tij në varrezat e dëshmorëve në fshatin Abri. Bekimi, i cili ra dëshmor para 25 viteve në betejën e UÇK-së në fshatin Tërstenik, kujtohet për sakrificën e tij për lirinë dhe pavarësinë e

Kosovës. "Lavdi të gjithë dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që dhanë jetën për çlirimin e vendit tonë!", është thënë në njoftimin e komunës së Drenasit.



Personat me sindromën down, pjesë e pandashme e shoqërisë

MALISHEVË, 21 MARS - Të enjten në Malishevë, mbështetur nga Drejtoria për Arsim dhe Edukim, me rastin e shënimit të Ditës Botërore të Sindromës Down, është mbajtur një aktivitet me nxënësit me këtë sindromë nga të gjitha shkollat e kësaj komune.

Drejtoresha e Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, Arbëreshë Krasniqi, ka shprehur përkushtimin e saj ndaj tyre, duke theksuar se: "Ne të gjithë jemi të barabartë dhe trajtimi duhet të jetë i tillë. Mësimi në gjithëpërfshirje është funksional në shkollat tona. Dhe edukimi i hershëm po vazhdon të rritet, duke ofruar mundësi të barabarta për të gjithë nxënësit tanë. Nxënësit



me sindromën down kanë përparësi në shkollimin e hershëm dhe mësimdhënësit janë adekuatë".

Ajo ka theksuar se ky organizim duhet të shërbejë si mundësi e mirë për të gjithë, pa dallim, për

sensibilizim dhe ndërgjegjësim për këtë komunitet. "Të gjithë duhet të bëjmë edhe më shumë, jo

vetëm në aspektin institucional. Duhet të krijohet një mjedis i shëndoshë për t'i përkrahur këta nxënës jo vetëm në përfshirjen në arsimin publik, por në jetë në përgjithësi dhe të barabartë", ka thënë drejtoresha Krasniqi, e cila e ka falënderuar edhe kryetarin e komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati, për mirëkuptimin dhe mbështetjen e këtij aktiviteti. Pjesëmarrja e prindërve, zyrtarëve policorë dhe zyrtarëve të qendrës rehabilituese "Handikos" në Malishevë theksoi përkushtimin e të gjithë shoqërisë në integrimin dhe mbështetjen e plotë të personave me sindromën down.

Parandalohet një rast i kontrabandës së mallrave prej 10 mijë eurosh në rrugën Preshevë - Gjilan

GJILAN, 21 MARS - Policia dhe Dogana e Kosovës kanë parandaluar një rast të kontrabandës së mallrave në rrugën Preshevë - Gjilan. Sipas komunikatës për medie, Policia dhe Dogana e Kosovës, në zbatim të masave për parandalim dhe luftimin e kontrabandës, kanë shtuar kontrollat taktike dhe operacionale në zonën kufitare në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë. "Më datë 20.03.2024, në rrugën

Preshevë - Gjilan, njësitet e lartcekura të Task-forcës, kanë tentuar ta ndalojnë veturën me targa të Serbisë. Drejtuesi i automjetit nuk ka zbatuar urdhëratë për ndalje dhe ka tentuar të kthehet në drejtim të Serbisë. Në dalje të fshatit Pasjan, kanë arrit të ndalojnë automjetin e dyshuar me drejtues Q.H., dhe pasagjer Y.Sh., që të dy nga Presheva. Gjatë kontrollit të automjetit, është vërejtur se në veturë

kishte të ngarkuara disa thasë me nxehtësi të ndryshme për bojlerë dhe shporet elektrik (934 copë, mall me origjinë nga Serbia, vlera e tregut është mbi 10.000 euro)", është theksuar në komunikatën e Policisë së Kosovës. Lidhur me rastin, të gjitha veprimet janë ndërmarrë në bashkëpunim me Prokurorinë e Shtetit, kurse me urdhër të prokurorit drejtuesi i automjetit ndalohet për 48 orë.



Të rinjtë ferizajas të interesuar në fushën e dizajnit të modës



FERIZAJ, 21 MARS - Në Ferizaj qëndroi për vizitë drejtoresha ekzekutive e Unionit të Bashkive Shqiptare në Rajon, Andriola Morina-Kambo, me bashkëpunëtorë, e cila u prit në takim nga kryetari i komunës së Ferizajt, Agim Aliu. Pjesë e kësaj vizite ishte edhe

ndarja e informacionit për të rinjtë e talentuar në fushën e dizajnit - modës - për thirrjen e hapur nga 'Muza Competition' dhe për të bashkëbiseduar se si duhet të bazohemi dhe t'i ruajmë elementët e etnografisë kombëtare dhe trashëgimisë kulturore. Me këtë rast, mysafirët nga UBShR-ja,

shoqëruar nga drejtori i Zhvillimit Ekonomik, Balton Dërguti dhe shefi i kabinetit të kryetarit të komunës së Ferizajt, Albion Sherifi, u pritën në shkollën e Agrobiznesit dhe Teknologjisë "Zenel Hajdini" në Ferizaj nga drejtuesit, mësimdhënësit dhe nxënësit e kësaj shkolle.

Totaj takon drejtuesit e "Autostrada Biennale" në Prizren

Prizren, 21 mars - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka takuar drejtuesit e "Autostrada Biennale" në Prizren, Leutrim Fishekqiu

dhe Vatra Abrashi, ku biseduan për potencialet dhe mundësitë për ta përforcuar zhvillimin ekonomik të qytetit përmes turizmit kulturor.

Gjatë takimit diskutuan për zgjerimin e hapësirave kulturore në Prizren dhe për rifunksionalizimin e disa prej tyre, që do të ndikonin në

përmirësimin e infrastrukturës kulturore dhe në krijimin e mjediseve të duhura për zhvillimin e turizmit.



Për herë të parë në QKUK kryhet procedura e kateterizimit në zemrën e një fëmijë

PRISHTINË, 21 MARS - Për herë të parë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, nga stafi i mjekëve të QKUK-së, është kryer procedura e kateterizimit në zemër te një fëmijë i moshës 14-vjeçare. Procedura është kryer nga mjekët e Klinikës së Pediatriisë, në bashkëpunim me ata të

Klinikës së Kardiologjisë. Fëmija L. S. ishte diagnostikuar me hipertension arterial të ngritur dhe i është bërë ekzaminimi invaziv hemodinamik me qëllim të zbulimit të ndonjë ngushtimi të arterieve. Ekzaminimi Invaziv është kryer në sallën e

Hemodinamikës të Klinikës së Kardiologjisë. Ekzaminimi është kryer vetëm nga stafi vendor i mjekëve dhe infermierëve dhe procedura ka kaluar pa komplikime. Fëmija, pas procedurës, është transferuar në Klinikën e Pediatriisë.



Përfundon konferenca e 'Javës së Gruas 2024', theksohet nevoja për një qeverisje gjithëpërfshirëse

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 21 MARS - Ka përfunduar konferenca dyditore e 'Javës së Gruas 2024', e organizuar nga Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), mbështetur nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

NDI ka falënderuar Ambasadën e Kanadasë në Kroaci dhe Kosovë për mbështetjen e programit dyditor të Javës së Gruas 2024. Në edicionin e 11-të të 'Javës së Gruas', mbi 120 pjesëmarrës u bashkuan për temën "Udhëhiq

me gjithëpërfshirje: ndërthurja e politikës me ekonominë" të fokusuar në domosdoshmërinë për ndërthurjen në mes të lidershit gjithëpërfshirës, politikës dhe ekonomisë, dhe ndikimin e tyre në formimin e shoqërive të shëndosha. Udhëheqja gjithëpërfshirëse është çelësi për sigurimin e kohezionit social, rritjes ekonomike dhe forcimin e qeverisjes demokratike.

Në një adresim kryesor të ditës së dytë të konferencës, presidentja Vjosa Osmani ka thënë se përballja me sfidat në shekullin 21 kërkon ndryshime në botëkuptimet e mënyrës se si ne organizojmë shoqëritë tona. "Nuk mund të vazhdojmë të

mbështetemi në modelet e vjetra të mendimit dhe veprimit, të cilat kanë prodhuar vazhdimisht pabarazi. Aty ku ka gjithëpërfshirje, aty ka përparim, mirëqenie dhe demokracia, lulëzon në mënyrën më të mirë", ka thënë ajo.

Tema kryesore e 'Javës së Gruas 2024' synon që përmes sesioneve të ndryshme të sjellë një dialog të hapur që vë në pah praktikën dhe përfitimet e të udhëhequrit me gjithëpërfshirje, si një parim fundamental qeverisjeje që merr parasysh nevojat e individëve dhe grupeve të ndryshme të shoqërisë, duke përfshirë pikëpamjet e grave, komuniteteve joshumicë, të rinjve, personave me aftësi të kufizuara, LGBTQI+ dhe grupe të tjera të

nënpërfaqësuar.

Në panelet e zhvilluara u theksua nevoja për një qeverisje gjithëpërfshirëse përmes politikëbërjes dhe strategjive për tejkalimin e barrierave diskriminuese për një qasje të barabartë për të gjithë qytetarët. Aktivizmi politik u prezantua si mjet i fuqishëm për të ndërmarrë ndryshime sociale dhe për t'i garantuar të drejtat themelore të njeriut për ndryshim të politikave me rëndësi qenësore për formimin e një shoqërie të hapur, të drejtë dhe të barabartë.

Qeverisja lokale është parë si kryesore për integrimin e perspektivës së ndjeshme gjinore për të siguruar ambient më gjithëpërfshirës dhe fuqizues për

ndërveprim në jetën publike.

Java e Gruas (WoW) është një ngjarje vjetore mbarëkombëtare që mbledh në një mjedis ndëretnik më shumë se 120 gra dhe burra nga partitë politike, shoqëria civile, biznesi, media dhe akademia, me qëllim të zgjerimit dhe forcimit të shkathtësive të grave udhëheqëse dhe mbështetjes së tyre për të marrë pozicione të larta drejtuese. Gjatë dymbëdhjetë viteve të fundit WoW ka ofruar një platformë për dialog mbi politika dhe diskutim intensiv me liderë politikë dhe zyrtarë të zgjedhur, duke u mundësuar pjesëmarrësve t'i mbajnë përgjegjës përfaqësuesit e tyre dhe ta mbështesin zhvillimin e shkathtësive për gratë në politikë.

Kosova dhe Shqipëria diskutojnë për mundësitë e bashkëpunimit mes dy forcave ushtarake

Prishtinë, 21 mars - Në ambientet e Komandës së Forcave Tokësore (KFT), komandanti i KFT-së, gjeneralbrigade Hysen Dreshaj, ka prituri në vizitë delegacionin nga Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSh) të kryesuar nga Komandanti i Forcave Tokësore të FARSh-

it, gjeneralmajor Ilir Xhebeuxhia. Gjeneral Dreshaj e njoftoi gjeneralin Xhebeuxhia me të arriturat dhe sfidat e KFT-së, për ngritjen e kapaciteteve luftarake, gjithashtu diskutuan edhe për mundësitë e bashkëpunimit në mes të dy forcave me fokus trajnimet dhe

stërvitjet e përbashkëta. Gjeneralët shprehën gatishmërinë e tyre për një bashkëpunim në fusha të interesit të përbashkët, për ngritjen e kapaciteteve dhe kontributin e tyre në të mirë të të dyja vendeve dhe interesit të përgjithshëm në të mirë të paqes në rajon dhe më gjerë.



Aeroporti i Prishtinës do të kompensohet për periudhën e pandemisë, tarifa e koncesionimit rritet në 55 për qind

PRISHTINË, 21 MARS - Pas miratimit nga Komiteti për Partneritet Publiko-Privat është nënshkruar amendamenti i marrëveshjes së koncesionimit për Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari", i cili parasheh kompensimin e periudhës së pandemisë si forcë madhore. Bazuar në dispozitat e marrëveshjes bazë të koncesionimit, Komiteti për

PPP ka njohur periudhën prej 20 muajsh si periudhë të pandemisë gjatë së cilës aeroporti ka operuar me ndërprerje apo me kufizime, për të cilën periudhë marrëveshja bazë parasheh zgjatjen e afatit proporcionalisht në fund të periudhës së koncesionimit në rastet kur kemi të bëjmë me forcë madhore. Për periudhën që parashihet të kompensohet, tarifa e

koncesionimit që përfiton Republika e Kosovës do të jetë 55 %, gjë që paraqet rritje substanciale krahasuar me përqindjen e paraparë gjatë periudhës së pandemisë në vitet 2020 dhe 2021, e që ishte 34 %, përkatësisht 37 %. Kjo gjë është reflektuar edhe në amendamentin e nënshkruar, i cili bën zbatimin e këtyre dispozitave të marrëveshjes bazë dhe kornizës ligjore në fuqi.



Auditimit të ZKA-së i nënshtrohet edhe ndërmarrja "Prishtina Parking"

Prishtinë, 21 mars - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) për sezonin auditues 2023/2024 është duke kryer auditimin e performancës "Menaxhimi i parkingjeve publike në qytetin e Prishtinës nga Ndërmarrja Publike Lokale "Prishtina Parking". Procesit të këtij auditimi do t'i nënshtrohet komuna e Prishtinës, përkatësisht Drejtoria për Inspektim dhe Ndërmarrja Publike Lokale "Prishtina Parking", e cila ka rol të rëndësishëm në organizimin, rregullimin dhe menaxhimin parkimeve publike në qytetin e Prishtinës.

Auditimi do ta vlerësojë efikasitetin dhe efektivitetin e shërbimeve për qytetarët, ofruar nga NPL "Prishtina Parking", si dhe masat dhe veprimet për menaxhimin e parkingjeve dhe bashkëpunimin me Inspektoratin e komunës së

Prishtinës dhe Policinë e Kosovës.

Fokusi i këtij auditimi do të jetë: Nëse "Prishtina Parking" ka bërë shënjimimin e parkingjeve për qytetarët dhe i ka informuar ata për mënyrat dhe format e parkimit në qytet, si dhe ka siguruar disponueshmëri të parkingjeve, qasje të barabartë për të gjithë, duke vendosur në prioritetet banorët rezidentë; Nëse "Prishtina Parking" ka siguruar forma të duhura të informimit të qytetarëve, të nevojshme dhe të lehta për të paguar qytetarët për shfrytëzimin e këtyre parkimeve, si dhe nëse ka siguruar një sistem të mirëfilltë dhe të sigurt të pagesave të parkimeve me laura duke shmangur keqpërdorimet nga zyrtarët e ndërmarrjes; Nëse ka një bashkëpunim të duhur me komunën e Prishtinës, më konkretisht me Inspektoratin për përcjelljen dhe inspektimin e



parkimeve të cilat shfrytëzohen nga qytetarët; si dhe nëse ka arritur të ndërtojë një sistem bashkëpunimi edhe me Policinë e Kosovës për mbarëvajtjen e parkimit të veturave në qytet duke synuar një organizim më të mirë.

Duke marrë parasysh rëndësinë e menaxhimit të parkimeve në qytetin e Prishtinës, të stërngarkuar nga veturat, Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) përmes këtij auditimi synon ta bëjë vlerësimin e gjendjes, nëse

"Prishtina Parking", në bashkëpunim me komunën e Prishtinës, kanë sistem të mirëfilltë të ofrimit të parkimeve për qytetarët dhe janë duke e menaxhuar atë në mënyrën e duhur dhe efektive.

Zgjerimi i rrugës Kijevë - Dollc, ndahen mbi 20 milionë euro për kompanitë që do t'i kryejnë punimet



Prishtinë, 21 mars - Është finalizuar procesi i përzgjedhjes së kontraktuesve për zgjerimin e rrugës nacionale Kijevë - Dollc.

Ministria e Infrastrukturës ka përzgjedhur kompanitë fituese për tri prej katër llojeve të tenderit për "Zgjerimin e Rrugës Nacionale N9- Segmenti Kijevë-Dollc".

Sipas kontratës të publikuar në E-prokurimi, llotet 2, 3 dhe 4 i kanë kushtuar në total Ministrisë së Infrastrukturës mbi 20 milionë euro.

Punimet për llotin e dytë sipas kontratës do t'i kryejë grupi i operatorëve ekonomikë "Empreus" Sh. P. K. nga komuna e Prishtinës.

Vlera e kontratës së dhënë për

këtë llot është 6 milionë e 232 mijë e 360 euro.

Punimet në llotin e tretë për "Zgjerimin e Rrugës Nacionale N9-Segmenti Kijevë-Dollc" do të kryhen nga kompania "Lika Trade" Sh. P. K nga komuna e Deçanit dhe "Tofi Doo", një kompanie me seli në Rozhajë të Malit të Zi.

Vlera e kësaj kontrate është 5 milionë e 436 mijë e 485 euro.

Kruesë në llotin e katërt fituese e kontratës është përzgjedhur një konsorcium i udhëhequr nga "Famis Co-HC", një kompani nga Suhareka.

Vlera e kontratës për këtë llot është 9 milionë e 315 mijë e 268 euro.

Për një llot tjetër ende nuk kanë përfunduar procedurat.

Inspektimet vazhdojnë në komunën e Pejës

PEJË, 21 MARS - Kësaj radhe inspektimet për identifikimin e punëtorëve të padeklaruar kanë vazhduar në komunën e Pejës.

Inspektorët e të ATK-së dhe të Inspektoratit të Punës, shoqëruar nga zëvendësministri Agon Dobruna dhe kryeinspektori

i IP-së, Hekuran Nikçi, kanë vizituar bizneset në sektorët e gastronomisë, tregtisë ushqimore dhe tregtisë farmaceutike. Në këto vizita

janë identifikuar raste të punëtorëve të paformalizuar dhe pa kontrata pune, ku për punëdhënësit e tyre janë iniciuar procedurat e gjobës.



DOKUMENTE BRITANIKE PER DEMONSTRAT E VITIT 1981 NË KOSOVË (7)



Prof. dr. Sabit SYLA & Prof. dr. Hamit KABA

-18-

RFE-RL
Organizata Ndërkombëtare Radio Free Europe

Departamenti i Kërkimit
Raport i RAD i Historikut/117
(Jugosllavia)
28 prill 1981

Ngjarjet e Kosovës në perspektivë nga Patrick Moore

Përmbledhje: Ky dokument përmbledh kronologjinë dhe shkaqet kryesore të ngjarjeve të fundit në Kosovë. Dokumenti përfshin disa komente që kanë dalë në shtypin Perëndimor dhe ofron konkluzione paraprake.

Në mars dhe sidomos në fillim të prillit ndodhën një sërë trazirash në Krahinën Autonome të Kosovës në Republikën Socialiste Jugosllave të Serbisë, një krahinë e cila në pjesën më të madhe është etnikisht shqiptare. Të marra së bashku këto greva, demonstrata dhe trazira, përbëjnë jo vetëm kërcënimin më të madh për stabilitetin e brendshëm në këtë vend që pas vdekjes së Titos më parë, situata në Kosovë është potencialisht më shpërthyes për 2 arsye: së pari, ndërsa vështirësitë e mëparshme ishin të kufizuara kryesisht me elitat relativisht të vogla politike dhe kulturore lokale, këto të fundit kanë marrë karakter masiv; natyrisht që një numër më i madh është më i vështirë të menaxhohet. Së dyti, ndërkohë që nacionalizmi kroat shpesh merr ngjyrimë separatiste, nuk ka asnjë aleat të jashtëm të dukshëm dhe nuk është irredenta e një vendi tjetër; megjithatë, shqiptarët e Kosovës (dhe të tjerë të Jugosllavisë) janë vendosur kryesisht në përqendrim të mëdha pranë shtetit të pavarur shqiptar, dhe problemet e tyre shpesh mund të shkaktojnë vështirësi në politikën e jashtme të Beogradit me Tiranën, siç edhe ka ndodhur këtë herë. Trazirat në Kosovë janë me përkufizim si vendore ashtu edhe ndërkombëtare për nga qëllimi.

Zhvillimet

Të përmbledhura shkurtimisht, ngjarjet kanë ndjekur kursin në vijim:

11-26 mars Kanë ndodhur një sërë përlëshjesh të armatosura midis policisë jugosllave dhe studentëve shqiptarë në Universitetin e Prishtinës, në dukje të nxitura nga ankesat e studentëve mbi kushtet e ushqimit dhe jetesës, dhe pamjaftueshmërinë e kuotave të tyre përballë normës më të lartë të inflacionit në Evropë (treth 40%). Më 26 mars, shpërtheu një grevë afër Podujevës, ku morën pjesë shumë punëtorë, si rezultat i së cilës 35 veta u plagosën dhe 21 u arrestuan. Disa javë më parë një zjarr shkatërroi banesën e famullorit të një kisha ortodokse serbe në Pejë, shkaku i raportuar i të cilit ishte rrjeti i dobët elektrik, por që bëri shumë serbë të dyshonin se ishte zjarr vënie e qëllimshme për motive politike.

1-2 prill - Në lokalitete të ndryshme filluan një seri demonstratash me ngjyrimë nacionaliste shqiptare në dukje të organizuara, dhe shpejt shpërtheu dhuna. Megjithëse autoritetet jugosllave në fillim mohuan raportimet për vdekje, rëndimi i situatës u bë shpejt i dukshëm kur u morën një sërë masash të rrepta: në krahinë u shpall gjendja e jashtëzakonshme (e para që prej Luftës së Dytë Botërore); u shpall ndalimqarkullimi gjatë orëve 20.00-05.00 në Prishtinë, Podujevë, Lipjanë, Vushtrri dhe Glogovc; u ndaluan tubimet prej më shumë se 5 personash; dhe Kosova u vendos jashtë kufijve të lejuar për gazetarët e huaj. Prishtina u rrethua nga një kordon tankesh, u ngritën pika të shumta kontrolli, dhe u sollën aty trupa dhe policë nga pjesë të tjera të Jugosllavisë. Disa fshatra serbe ngritën bllokada mbrojtëse kundër sulmeve të mundshme shqiptare.

2-5 prill - U pezullua një ndeshje futbollit e planifikuar të zhvillohej më 5 prill në Prishtinë, por më 4 prill u inaugurua një hidrocentral që do të prodhojë 94, 600, 000 kvh në vit, në mesin e një fanfare në shtypin jugosllav për të theksuar se jeta në Kosovë i është kthyer normalitetit. Gjatë këtyre ditëve u bënë një sërë mbledhjesh partiake dhe qeveritare dhe një larmi zyrtarësh bënë deklarata për

trazirat. Këto mbledhje përfshinin sekretarin e Kryesisë së KQ-së së LKJ-së, Dushan Dragosavac; përfaqësuesin e Kosovës në Kryesinë Shtetërore Federative dhe figurën udhëheqëse politike Fadil Hoxha; kryetarin e Republikës Serbe, Dobrovoje Vidic; kryetarin e Lidhjes së Komunistëve të Kosovës, Mahmut Bakalli; dhe kryetarin Rajonal të Kosovës, Xhavit Nimani. E përditshmja "Rilindja" e Prishtinës dhe disa gazeta të tjera jugosllave, gjithashtu e adresuan çështjen në fjalë. Kështu, vija e përgjithshme që doli, ishte se një grup i vogël ekstremistësh nacionalistë të mirë organizuar të krahut të djathtë dhe "Informbyro" [Kominternit] të krahut të majtë me përkrahje nga jashtë kanë orkestruar të gjithë çështjen, duke manipuluar në mënyrë të paturpshme disa qytetarë të mirë.

6 prill - Organizata e partisë së Kosovës nga ana e saj e dënoi "punën e organizuar dhe brutale" të "kundërrevolucionarëve" dhe "irredentistëve", të cilët, gjithsesi, u kundërshtuan nga "shumica dërrmuese" e Kosovarëve. Në të njëjtën ditë, anëtari i Kryesisë së KQ-së së LK-së, Stane Dolanc, mbajti një konferencë për shtyp për rreth 200 gazetarë të huaj dhe jugosllavë ku bëri prononcimin më autoritar deri në atë ditë mbi trazirat. Megjithatë, sipas versionit të paraqitur të nesërmen në gazetën Vjesnik, ai ndoqi një vijë të ngjashme, duke bërë të ditur se 11 persona ishin vrarë dhe 57 ishin plagosur dhe mesa duket duke u rrekur shumë për të thënë se forcat e sigurisë ishin sjellë mirë dhe se ato lokale përbëheshin kryesisht nga shqiptarë. Ai i mohoi raportet se Tirana kishte paraqitur një notë proteste pranë Beogradit për incidentin, iu shmang fajësimin (apo shprehimisht shfajësimin) të qeverisë shqiptare për trazirat, por ndërkohë që fajin e vinte kryesisht në derë të "armiqve" të jashtëm me qëllim për të "destabilizuar Jugosllavinë", ai shtoi se "do të ishim qorr dhe të shurdhër politikisht nëse çdo gjë do ta reduktonim tek faktorët e jashtëm". Dolanc vuri në dukje se irredentizmi në Kosovë nuk erdhi si befasi, por e kundërta ndodhi me "brutalitetin" e protestuesve. Shkurtimisht, për pjesën më të madhe Dolanc vetëm sa amplifikoi vërejtjet e mëparshme të bëra nga zyrtarë të tjerë. Gazetarët perëndimorë dukeshin se kishin dijeni të plotë për dobësinë që kishte Jugosllavia zyrtare për t'ia futuruar shqetësimet e brendshme elementëve të jashtëm dhe për t'u përpjekur për t'i shmangur problemet, duke filluar sulmet kundër kërcënimeve të jashtme të supozuara. Në vend të kësaj, gazetarët theksuan në artikujt e tyre problemet e ndërlikuara etnike, sociale dhe ekonomike dhe duket se nuk u bindën nga vija jugosllave. Duke gjykuar nga trajtimi i tyre, që u përqendrua pothuaj plotësisht në rrënjët e brendshme të pakënaqësisë, pjesa

më e madhe nisur ndoshta, së paku kundër dëshirës, do të bashkoheshin me vërejtjen e mëvonshme të gazetës "Zëri i Popullit" se shpjegimi jugosllav tregoi "mungesë të plotë të çdo analize realiste".

8 prill - Në të njëjtën ditë që u hoq ndalimqarkullimi në Kosovë, e përditshmja e palës shqiptare "Zëri i Popullit" i dha trazirave një dimension krejt të ri duke e sulmuar qëndrimin jugosllav me ashpërsi, me agresivitet dhe në një stil polemizues. Gazeta e Tiranës mbështeti me pasion demonstruesit, duke përfshirë kërkesën e tyre për ta bërë Kosovën republikë federale jugosllave të pavarur nga Serbia. Përmbajtja e artikullit, i cili duket se jep të dhëna të stilit të vetë kryeministrit, Mehmet Shehu, ishte qartazi antiserb (megjithatë, pa sulmuar udhëheqjen lokale shqiptare apo Titon), përfshinte një pretendim me sa duket irredentist se "Traktati i Londrës, Traktati i Versajës, apo çdo traktat tjetër imperialist, nuk mund të imponohen më në kurriz të popullit shqiptar", dhe i përshkruante shqiptarët e Shqipërisë dhe ato të Kosovës si "një popull dhe një komb". (Rëndësia e editorialit nënvizohet nga fakti se është përkthyer menjëherë në gjuhën angleze në formën e broshurës). Po atë mbrëmje, komentatori i njohur i Radio Zagrebit, Milika Sundic, foli qartë, duke e përshkruar artikullin shqiptar si mbështetës të përpjekjeve për të minuar vetë ekzistencën e Jugosllavisë.

9 prill - Të nesërmen në mëngjes, edhe gazeta "Rilindja" iu përgjigj Tiranës. Përveç se akuzoi ZP-në për "ndërrhyrje flagrante" në çështjet e brendshme të Jugosllavisë, për tradhti të interesave reale të popullsisë shqiptare të Kosovës dhe hodhi dyshime mbi pretendimin e Tiranës se dëshironte marrëdhënie të mira me Jugosllavinë, "Rilindja" vuri në dukje se për Shqipërinë që të kundërshtonte integritetin e fqinj të saj, ishte që "t'i hynte një aventure politike e cila mund të çonte në vetëvrasje". Ajo që nënkuptonte gazeta e Prishtinës me sa duket është se siguria e secilit prej vendeve të pavarura komuniste të Ballkanit (d.m.th., duke përfshirë Rumaninë) karshi Moskës, është e lidhur ngushtë me atë të vendeve të tjera; kështu, dobësimi i njërit vend nënkupton në një kontekst gjeopolitik, kërcënim për të gjithë. Tirana nga ana e saj e ka ngritur këtë çështje më parë, gjë që e bën edhe më të papritur ashpërsinë e sulmit të ZP-së. Në përfundim, gazeta "Rilindja" përsëriti pozitën jugosllave se shumica dërrmuese e kosovarëve janë besnikë të Jugosllavisë socialiste, dhe krahasoi qëndrimin e tyre me nacionalizmin e ulët dhe reaksionar të Tiranës.

10 prill - Në një tjetër batore nga kryeqyteti shqiptar, e përditshmja "Bashkimi", akuzoi autoritetet jugosllave se direkt apo indirekt

janë përpjekur të zbukurojnë censurin jugosllav në dëm të pozitës shqiptare, duke pasqyruar dyshimin e shprehur herë pas here nga pakicat kombëtare për statistikën e popullsisë, dhe jo vetëm në Jugosllavi.

11 prill - Sundic u shpreh se Shqipëria ndoshta kishte plane territoriale kundër Jugosllavisë.

13 prill - Rinisi mësimi në shkollat fillore në Prishtinë. Tanjug përmbante një përmbledhje të sulmeve të përditshme të Jugosllavisë ndaj Tiranës.

14 prill - Azem Vllasi, anëtar i shoqatës rajonale të Aleancës Socialiste të Popullit Punëtor të Kosovës, i rregulloi shifrat zyrtare jugosllave në 9 të vdekur dhe 261 të plagosur. Gazeta "Bashkimi" pretendonte për 308 të vdekur, dhe po këto ditë zyrtarë shqiptarë jashtë vendit përcollën ngjarje sensacionale tek gazetarët Perëndimorë.

17 prill - Tanjug përmbante një deklaratë të Bakallit se 28 "organizatorë" të trazirave ishin "nën hetim" dhe se shkollat e mesme dhe Universiteti i Prishtinës do të rihapeshin më 20 prill. Ai refuzoi të negocionte për kërkesat e demonstruesve dhe, në një përgjigje ndaj ZP-së dhe ndaj studentëve deklaroi se "kërkesa që Kosova të bëhet Republikë është në kundërshtim me arritjet e revolucionit dhe me kushtetutën jugosllave".

E përjavshmja e Beogradit gazeta "NIN" vuri në dukje se demonstruesit ishin organizuar, "duke lëvizur në mënyrë të tillë sikur dikush po i drejtonte ata me radio marrëse-dhënëse". Artikulli tregonte parullën e protestuesve "Jemi bijë të Skënderbeut, jemi armata e Enver Hoxhës", që pasqyronte një qasje "romantiko-borgjeze për historinë e tyre" dhe një keqkuptim të plotë të "modelit të fundit të fosilizuar stalinist". Përsëri duke nxitur vijën e komplotit armiqësor, gazeta "NIN" pretendonte se "armiku e kuptoi që shumë njerëz nuk do të" shihnin përtej kësaj parulle të zgjuar.

18 prill - Radio Beogradit raportoi një fjalim të mbajtur nga Fadil Hoxha në Prishtinë përpara një grupi anëtarësh partie që punojnë në fushën e kulturës dhe shkencës. Ai iu referua artikullit të "ZP" të datës 8 prill dhe shprehu "çudi", meqenëse "destabilizimi i Jugosllavisë nënkupton gjithashtu destabilizimin e vetë Shqipërisë". Hoxha duket se ka thënë atë që ishte e nevojshme pa ushqyer polemikë, duke adoptuar një vijë më agresive.

19 prill - Gazeta "Pravda" akuzoi një artikull të kohëve të fundit të gazetës "Borba" për "analizë jorealitike dhe provokative të politikave të komonuelthit socialist ... duke i hedhur ato në mënyrë arbitrare në një thes të madhe" me ato të Perëndimit, dhe për trajtimin e të dyja "fuqive të bllokut" si ekspansioniste. Ndoshta i gjithë diskursi jugosllav i

“informbyroistit” të jashtëm dhe kërcënimeve se pas trazirave të Kosovës qëndronin Fuqitë e Mëdha, nxitit sovjetikët që së paku të tregonin anën e tyre, por temat ofensive të cituara në gazetën “Pravda” kanë qenë për një kohë të gjatë pjesë e arsenalit ideologjik jugosllav. Kushdo pyet veten pse Moskë e ndjen vërtetë të nevojshme që të përfshihet në këtë ngatërresë të fundit Ballkanike. Dy periodikët drejtues serbë, e përjavshmeja “NIN” dhe e përditshmeja “Politika”, sulmuan trajtimin nga autoritetet jugosllave të ekskesit të medias në Kosovë. “NIN” tha se publiku ishte mbajtur qëllimisht “i painformuar”, ndërkohë që gazeta e përditshme tha: “Kush vendos çfarë është e përshtatshme dhe çfarë është e papërshtatshme”, duke pretenduar se interesat e “grupit me influencë” mbizotërojnë mbi “të drejtën e publikut për të ditur”, duke e mbajtur shtypin “në periferi të ngjarjeve” kur nevojitej pikërisht e kundërta.

Historiku
Pasione të tilla, dhuna, nervoziteti dhe shqetësimi natyrisht që nuk janë diçka që shfaqen thjesht menjëherë. Me të vërtetë, çështja e Kosovës ka dy rënjë kryesore, një rënjë të gjatë dhe të thellë që vazhdon prej shekujsh në rivalitetin dhe armiqësinë serbo-shqiptare, dhe një rënjë relativisht më të re, por gjithsesi të guximshme në zhvillimet socio-ekonomike në Kosovë në Jugosllavinë e pasluftës. 1. Faktorët historikë dhe emotivë. Është e pamundur që të kuptohen ngjarjet e Kosovës pa hyrë në grupet komplekse të perceptimeve, imazheve dhe miteve të ngritura nga serbët dhe shqiptarët për Kosovën, për veten e tyre dhe për njëri-tjetrin. Për serbët, Kosova ka rëndësi të pallogaritshme historike dhe emotive për dy arsye. Së pari, Kosova ishte pjesë e djepit të shtetit mesjetar serb dhe ende përmban disa nga monumentet e mëdha të trashëgimisë kulturore të këtij

populli, konkretisht kisha dhe manastire. Patriarkana mesjetare serbe e kishte selinë e saj në Pejë. Së dyti, brenda krahinës është Fushë Kosova, ku në vitin 1389, serbët humbën një betejë vendimtare me ushtritë otomane, duke shënuar kështu fillimin e fundit të shtetit të tyre mesjetar. Nga kjo ka lindur “miti i Kosovës” dytelesh si për të marrë hakun e humbjes ashtu edhe si një vend lavdie ku serbët zgjodhën që praktikisht të përballen me humbjen me armë në dorë dhe jo të dridheshin nga frika përpara turqve. Rëndësia e këtij elementi brenda vetimazhit më të gjerë popullor e kombëtar serb vështirë se mund të nënvlerësohet.

Sidoqoftë, në shekujt e mëvonshëm, për arsye komplekse politike dhe demografike, qendra e serbizmit u zhvendos gradualisht drejt veriut në Beograd dhe përtej territorit të Habsburgut. Në Kosovë (ashtu si në krahinat e Malit të Zi dhe Maqedonisë), vendi i sllavëve ortodoksë ishte marrë kryesisht nga shqiptarët myslimanë, kështu që popullsia e krahinës sot është diçka mbi 75% shqiptarë dhe nën 20% serbë, ku shqiptarët gjithnjë e më shumë gëzojnë përqindjen më të lartë të lindjeve në Evropë, pra në masën 26.0 për 1,000, dhe ku për më tepër serbët vazhdojnë të largohen nga krahina. Këto zhvillime marrin rëndësi më të madhe kur vërehet se, meqenëse popullsia shqiptare në Kosovë është rreth 1,300,000 dhe se vetë Shqipëria është vetëm 2,700,000, afërsisht një e treta deri një e dyta e të gjithë shqiptarëve në Evropë jetojnë në Kosovë e cila, meqenëse është pranë Shqipërisë, përbën proporcionalisht irridentën më të madhe të kontinentit. Prandaj, nëse serbët mund të pretendojnë Kosovën për arsye historike, shqiptarët mund të argumentojnë se e kanë këtë të drejtë mbi bazën e kombësisë së shumicës së popullsisë. Për më tepër, as shqiptarët nuk janë pa argumentet

e tyre historike, meqenëse pjesa më e madhe e zgjimit kombëtar shqiptar në fund të shekullit XIX dhe fillim të shekullit XX është përqendruar në qytetet kosovare si Prizreni dhe Prishtina. Grupi i parë mbarëshqiptar politik kombëtar ishte Lidhja e Prizrenit e vitit 1878; gjithashtu, një lëvizje me qendër në Prishtinë arriti të fitonte autonominë nga autoritetet otomane në vitin 1912.

Gjithsesi, serbët duke pasur shtet, ushtri dhe diplomaci më të fuqishme, mbizotëruan dhe përveç një intervali të shkurtër në Luftën e Dytë Botërore, kur Musolini ia aneksoi krahinën “Shqipërisë së Madhe” të tij, Kosova i është nënshtruar Beogradit që në vitin 1913. Në Jugosllavinë mbretërore të paralutës, shqiptarët janë trajtuar si një popull i nënshtruar dhe madje as nuk janë lejuar të hapin shkollë në gjuhën e tyre. Megjithatë, Mbreti Zog i Shqipërisë mori titullin irredentist “Mbreti i Shqiptarëve” (d.m.th. jo vetëm i Shqipërisë), një çështje që nuk qëndronte mirë për Beogradin. Pas luftës kontrolli serb vazhdoi të jetë i lartë dhe i vendosur deri kur në vitin 1965 u spastrua Ministri i Punëve të Brendshme, Aleksandër Ranković, i cili ishte serb. Në vitin 1968, Kosova u ngrit pas një sërë trazirash në statusin e krahinës autonome e cila kishte pothuajse të gjitha prerogativat praktike të një republike. Zgjidhja i qetësoi serbët, meqenëse teknikisht Kosova mbeti pjesë e Republikës serbe, ndërkohë që shqiptarët mund të gëzonin një rol gjithnjë në rritje me shpejtësi në udhëheqjen politike, burokraci, dhe establishmentin arsimor dhe kulturor; gjithashtu, krahina “e tyre” mori një fluks masiv parash nga zona më të zhvilluara të Jugosllavisë, duke përfshirë vetë Serbinë.

Para se t'i kthehemi Kutisë së Pandorës socio-ekonomike që këto përpjekje për zhvillim provuan se janë, duhet të thuhet pak fjalë mbi pikëpamjet e

serbëve dhe shqiptarëve për veten e tyre dhe njëri-tjetrin. Serbët e shihnin veten e tyre si populli (së bashku me kushërinjtë e tyre malazezë) i cili luftoi në të dyja luftërat botërore, për të mirën e të gjithë jugosllavëve, vënë theksin në traditat e tyre të tjera të shtetformimit dhe diplomacisë dhe vënë në dukje pozitën e tyre si grupi kombëtar i vetëm më i madh nga ana numerike në Jugosllavi. Ata e krahasojnë këtë me atë që e shohin si rol ndërhyrës në udhëheqjen e vendit (në të vërtetë, që pas dështimit të Rankovićit, asnjë nga figurat reale kryesore nuk ishte serbe), me dobësimin demografik dhe ndonjë dobësim tjetër të pozitës së tyre jo vetëm në Kosovë, por edhe në Bosnje, si dhe me mungesën e mbizotërimit të tyre kulturor, si diçka të simbolizuar nga tendenca e alfabetit latin për të nxjerrë nga përdorimi shkronjat e tyre cirilike. Shkurtimisht, ata ndjehen të hidhëruar dhe të mashtruar. Megjithatë, shqiptarët njëssoj si myslimanët e Bosnje e Hercegovinës besojnë se më në fund erdhi ora e tyre pas së paku dekadash të shtypjes, diskriminimit dhe fyerjeve nga serbët. Serbët nga ana e tyre, i shohin shqiptarët si agresivë, furacakë inferiorë nga pikëpamja kulturore, të cilët si myslimanë janë pjesë e “armikut historik turk”. Për më tepër, nacionalizmi shqiptar është i ri, burrëror, kokëfortë që njëssoj si nacionalizmi i hershëm rinor serb i vitit 1914 është i prirur për të renditur të parin unitetin kombëtar dhe konsideratat e tjera më pas (shih më poshtë).

2. Probleme sociale dhe ekonomike. Këto vështirësi komplekse janë analizuar gjerësisht në këtë seri, ndërkohë që konkluzionet e gjera në vijim duhet të mjaftojnë për këtëstudim.

a. Një sasi e mahnitshme parash ka vërshuar në Kosovë, por kjo sasi ka tentuar të shkojë në

industrinë e sofistikuar moderne (të cilat nuk punësojnë një numër të madh punëtorësh me kualifikim të dobët), administratë (e cila është e kushtueshme dhe krijon një klasë joproductive, por të privilegjuar), dhe projekte të tjera nga të cilat nuk përfiton shumica dërrmuese e popullsisë. Të ardhurat e tyre për frymë janë ende më të ulëta në vend dhe shumë shqiptarë dyshojnë se Kosova, në fakt po shfrytëzohet. Kjo krahinë ka gjithashtu normën më të lartë të papunësisë në Jugosllavi.

b. Zgjerimi masiv i arsimit duke përfshirë kalimin e Universitetit të Prishtinës në universitetin e tretë më të madh të Jugosllavisë, ka prodhuar një proletariat akademik me shpresa të rritura, por me mundësi të vogla për punë në Kosovë dhe kualifikimet e të cilit (veçanërisht vështirësitë e gjuhës) shpesh nuk njihen tjetërkund në Jugosllavi. Fakti që shumë prej tyre vijnë nga familje të varfra dhe janë dëmtuar rëndë nga norma e lartë e inflacionit në Jugosllavi, e shton hidhërimin e tyre. Duhet të kujtojmë se studentët e universitetit, të pashpresë dhe të papunë, përbënin pjesën më të madhe të fuqisë së gjallë për grupe ekstreme majtiste dhe radikale të djathta në të gjithë Evropën Lindore në vitet e paralutës: universitetet “ishin inkubatorë të vërtetë të burokratëve, politikanëve dhe demagogëve me tepriçë”. Nga e Majta, Milovan Gijlas dhe Enver Hoxha, midis të tjerëve, janë të përshtatshëm për këtë model social.

c. Këto tensione të ndryshme u pasqyruan në parullat e përsëritura pa pushim apo të shkruara nga demonstruesit, të raportuara në shtypin përendimor. Hidhërimi i studentëve të varfër të zemëruar nga “klasa e re” e privilegjuar pasqyrohet në parullat: “Poshtë revizionizmi! Rroftë marksizëm-leninizmi!” (një miratim i dukshëm i ortodoksisë egalitarene spartane e Enver Hoxhës ndaj sistemit



jugosllav), “Nuk Duam kapitalizmin, kuam socializmin”, dhe “Rroftë Enver Hoxha”. Nacionalizmi shqiptar shfaqet në parullat: “Jemi shqiptarë, jo jugosllavë”, dhe “Duam një Shqipëri të bashkuar”, ndërkohë që ndjenja e shfrytëzimit mund të perceptohet në parullën: “Kosova punon dhe Beogradi ndërton”.

Shtypi Perëndimor. Gazetat në shumë vende perëndimore përmbajnë komente të matura për Kosovën gjatë javëve të fundit, shpesh duke u përqendruar në temën e një “bombe me sahat” sociale në “strehën vorfënore” të Jugosllavisë. Një pjesë e përzgjedhur mund të përfshijë:

“Le Monde”, 6 prill 1981: “Njeriu nuk duhet të minimizojë ngjarjet që janë zhvilluar... Universiteti ka jo më pak se 37,000 studentë, por ekonomia rajonale nuk mund të marrë kaq shumë të diplomuar, e madje edhe ata që janë bilingualë flasin gjuhën e tyre amtare, shqipen, shumë më mirë se serbishten... Zhgënjimet e thella... u shndërruan menjëherë në nacionalizëm... nacionalizëm i ri që është veçanërisht virulent... Një pakicë aktive nuk do të kufizonte veten në kërkimin e statusit të Republikës brenda Jugosllavisë... dhe do të kërkonte t'i kthehej Shqipërisë, ... një kërkesë shpërthyesë tërësisht e papranueshme për udhëheqjen e Beogradit meqenëse në fund të fundit, do të nënkuptonte shpërbërjen e Federatës”.

“Die Welt”, 6 prill 1981, trajtoi kërkesën e Shqipërisë së Hoxhës drejtuar studentëve kosovarë, duke theksuar se “në anën tjetër të kufirit duket se mbizotëron rendi, disiplina dhe, megjithëse në varfëri, edhe një barazi e sigurt sociale”.

“Süddeutsche Zeitung”, 6 prill 1981, komentoi mbi rrënjët sociale të pakënaqësisë së studentëve duke theksuar se “ajo që është krijuar nuk janë specialistë të rinj për zhvillimin e krahinës por më tepër një proletariati akademik revolucionar shqiptar... Një numër gjithnjë në rritje i studentëve shpesh duhet të jetojë në konvikte të mjerueshme me shumë veta në një dhomë dhe nganjëherë dy veta në një krevat. Rritja e qirave në konvikte (siç e ka pranuar Tanjug indirekt kohët e fundit) duhet të ketë shërbyer si katalizator i trazirave... Shqetësimi social shfaqet jashtë qelizave të subversionit politik”.

“Stuttgarter Zeitung”, 6 prill 1981, paraqiti një tablo të kobshme. “A do t'i duhet Jugosllavisë në të ardhmen të jetojë me “vendit e vet Bask”?... Gjatë ditëve të fundit specialistë të shumtë serbë dhe malazezë në industri dhe ndërtim janë larguar nga Kosova për sigurinë e tyre. Duhet të ketë pasur eksese ndaj serbëve dhe malazezëve në Kosovë”.

“Handelsblatt”, 6 prill 1981, tha: “Kjo situatë e vajtueshme ekonomike dhe sociale buron, mbi të gjitha, nga dy shkaqe. I pari është ndjekja e një politike të gabuar nga partia dhe autoritetet në lidhje me procesin e industrializimit. Metoda të shumta... janë investuar në projekte industrial që as nuk sigurojnë punë të mjaftueshme dhe as nuk i vendosin punëtorët e Kosovës në një pozitë të tillë që të përdorin plotësisht fabrikat e tyre

industriale për shkak të teknologjisë moderne tepër të ndërlikuar. Për më tepër, depopullimi i fshatit ka marrë përmasa të mëdha. Megjithatë, shumë të rinj dëshirojnë që në vend që të bëhen punëtorë, të bëhen së paku akademikë, në mos zyrtarë”.

“AP”, 7 prill 1981, citoi disa nga vëzhguesit perëndimorë në Beograd për “frustrimet” e shtresës së inteligjencës”, por shtoi se “nuk është e habitshme se diçka e tillë do të ndodhte. Ajo që të habit është se demonstruesit ndërmorën një fokus të mprehtë politik”.

“The Times”, 7 prill 1981, trajtoi implikimet e situatës për Federatën jugosllave në tërësi, duke vënë në dukje se “testi kritik për pasuesit e Titos mund të arrijë deri në atë pikë ku... ambicinet nacionaliste dhe presionet ekonomike përkojnë me... Liberale megjithëse kuadri jugosllav tashmë është i tillë, gjithësi sunduesit komunistë kudo që janë, e kanë të vështirë të përshtaten me çdo gjë që duket se sfidon monopolin e tyre të pushtetit brenda sistemit një-partiak”.

“Die Welt”, 8 prill 1981, paraqiti një situatë në dukje të pashpresë, duke thënë se “udhëheqja jugosllave po përballet me një dilemë pothuajse të pazgjidhshme. Nëse ajo i jep shqiptarëve të gjitha të drejtat me qëllim që të rivendosë qetësinë, duke përfshirë vetëvendosjen, (të cilën Jugosllavia e deklaroi për çdo popull në Afrikë) kjo gjë do të ishte fundi i integritetit”.

“Frankfurter Allgemeine Zeitung”, 9 prill 1981, vuri në dukje disa nga dëshmitet kryesore, njësoj si të Polonisë për udhëheqjen e Beogradit, duke theksuar se “regjimi zhvillon një miniluftë permanente kundër fshatarëve privatë, të cilët ende përbëjnë rreth 70% të gjithë popullsisë së Kosovës... Nuk ekziston marrëdhënie mirëbesimi midis popullsisë shqiptare dhe udhëheqjes aktuale në Prishtinë”.

“Süddeutsche Zeitung”, 9 prill 1981, veçoi disa nga implikimet e kërkesës për Republikë federale shqiptare më vete, duke thënë se “regjimi jugosllav është i pazoti kundër kësaj... Siç pyeti edhe Dolanc në mënyrë retorike në konferencën e tij për shtyp “A dëshironi dy Kore? A dëshironi dy Gjermani?... Atë që Dolanc nuk e tha por që gjithësi e nënkuptoi, është kjo: popujt e ndarë kërkojnë ribashkimin e tyre”.

“Neue Zürcher Zeitung”, 10 prill 1981, e përqendroi gjithashtu vëmendjen e saj në çështjet politike, duke besuar se “gama më e madhe e problemeve janë padyshim marrëdhëniet e ndërlikuara serbo-shqiptare... Cilido duhet që në çdo rast të supozojë se do të ketë spastrime të gjithanshme në organizatën e partisë krahinore”.

“The Washington Post”, 19 prill 1981, komentoi mbi irredentizmin shqiptar, duke theksuar se, përveç kërkesave për statusin e Republikës, “kishte më shumë parulla nacionaliste që bënin thirrje për “Shqipërinë e Madhe”, e cila do të përfshinte pakicat shqiptare, jo vetëm në Kosovë por edhe në Mal të Zi dhe në Maqedoni”. Duke iu kthyer çështjes themelore, autori Dusko Doder pyeti: “Për sa kohë mund të



mbeten politikisht të ndarë këto dy komunitete të mëdha të të njëjtit popull? Fakti që Jugosllavia i ofron popullsisë së saj shqiptare një standard shumë më të lartë jetese dhe liri më të madhe politike dhe individuale sesa vetë Shqipëria, nuk i përjashton tendencat separatiste në radhët e shqiptarëve të arsimuar të Kosovës”.

“The New York Times”, 20 prill 1981, raportoi për një udhëtim të veçantë “të udhëzuar” për gazetarët në pjesën jashtë kufijve të saktuar për Kosovën, gjatë të cilit autoritetet vazhduan të përsërisnin akuzat e tyre të paqarta për “armikun”. Artikulli citoi gjithashtu disa serbë lokalë për ndjenjat e tyre të tilla si: “Nuk e kuptojmë çfarë kërkojnë shqiptarët, sepse ata kanë më shumë të drejta sesa ne, preferenca në strehim, punë, e madje edhe në konviktet e studentëve”. Një tjetër artikull, mesa duket për të plotësuar një farë shfaqjeje me rezervë tha: “Ne serbët nuk ndjehemi rehat me nacionalizmin shqiptar”.

Disa perspektiva. Në të vërtetë ka shumë pika që duken shqetësuese për skenën e Kosovës. Nëse sjellja në të kaluarën ofron ndonjë shenjë, ka të ngjarë që të ketë fjalime dhe spastrime në horizont por në të vërtetë ato nuk do të jenë të dobishme për problemet reale të Kosovës. Në fakt nuk duket se ka zgjidhje për këto vështirësi, të paktën për të ardhmen e parashikueshme, për shkak të madhësisë së tyre absolute.

Megjithatë, nëse duhen bërë përpjekje, gjëja e parë është që udhëheqja jugosllave të përballojë problemet në mënyrë të sinqertë dhe të hapur dhe të lërë mënjandë fshehtësinë dhe qasjen e moskomunikimit me njerëzit për vështirësitë e brendshme duke i fajësuar ata, ose duke shpërqendruar vëmendjen e tyre, përmes mjeteve të huaja. Ruajtja e kredibilitetit përpara një publiku politikisht të sofistikuar është shumë më e rëndësishme sot se në të kaluarën, meqenëse figura e Titos nuk është më e pranishme me autoritetin e tij politik dhe moral për të vepruar si arbitri vendimtar. Ngjarjet në Poloni nënvizuan rolin kryesor të kredibilitetit dhe besimit dhe komentet më të fundit të “NIN” dhe “Politika”, tregojnë se këto probleme kanë lidhje edhe me

Jugosllavinë.

Fusha e dytë e analizës është shoqëria dhe ekonomia në Kosovë. Është e vështirë që këto probleme të zgjidhen menjëherë, por të paktën mund të fillohet me zgjidhjen e tyre duke i kushtuar më shumë vëmendje fshatarit privat, industrive të gjera në zhvillim për të tërhequr krahun e punës dhe për të gjetur mjetet për të punësuar proletariatin e madh akademik, ndërkohë që duhen bërë përpjekje për të mos lejuar që numri i këtij proletariati të bëhet kaq i lartë përsëri në të ardhmen.

Kjo ka lidhje me një fushë të tretë, duke reduktuar thirrjen ideologjike të komunizmit egalitarian të Hoxhës, ose mbase edhe modelin sovjetik, duke treguar se sistemi jugosllav mund të ofrojë jetesë të denjë për popullsinë e vet. Modeli shqiptar ndoshta do të ketë gjithmonë njëfarë tërheqjeje për shqiptarët e Jugosllavisë sepse ky model përfshin një numër vlerash tradicionale shqiptare. Megjithatë, përballë pabarazive të dukshme sociale në të cilat duket se të pasurit bëhen më të pasur dhe të varfërit më të varfër, sistemi jugosllav do të duhet të provojë vlerën e vet nëse, jo vetëm socializmi i Hoxhës, por në mënyrë më kërcënuese edhe modeli sovjetik do të duhet që të humbin së paku thirrjen e tyre të mundshme ndaj zonave të pazhvilluara të Jugosllavisë. Vëzhguesit që njohin jo vetëm Kosovën por edhe Bosnje e Hercegovinën dhe zona të tjera më pak të pasura, kanë vënë re për një kohë të gjatë një zemërim të thellë ndaj pabarazive në dukje josocialiste që sistemi jugosllav jo vetëm i toleron, por duket se edhe i ushqen gjithashtu; disa njerëz, veçanërisht studentët, i kanë parë modelet ortodokse, përfshirë atë sovjetik më shumë si përgjigje. Kombinoni këto ndjenja me irredentizmin shqiptar, ose me ndjenjat serbe (dhe, në një farë mase malazeze) të frustrimit dhe rusofilinë romantike dhe në të vërtetë çdokush do të ketë një dehe marramendëse.

Problemi i katërt, ndoshta plotësisht i pazgjidhshëm brenda Federatës Jugosllave, është nacionalizmi shqiptar. Ashtu si kolegu i tij ndaj Monarkisë Habsburge në vitin 1914, dhe në kontrast me pjekurinë politike të hungarezëve të Vojvodinës së

sotme, të cilët duken se janë mjaft mirënjohës për lirinë dhe prosperitetin në Jugosllavi në krahasim me Hungarinë, nacionalizmi shqiptar është agresiv dhe i fortë dhe tenton të vërë bashkimin kombëtar përpara çështjeve të lirisë personale apo të mirëqenies materiale dhe kulturore. Në një shtet emri i të cilit do të thotë “toka e sllavëve të Jugut”, shqiptarët janë ndoshta me përkufizim të jashtëm, dhe duke pasur parasysh vështirësitë e tjera dhe përparshme politike, sociale dhe ekonomike, mund të ketë gjithnjë rritje të ndjenjave në mesin e shqiptarëve të Jugosllavisë se e ardhmja e tyre qëndron në Tiranë. Kjo pikë na çon në fushën e pestë, qëndrimi i serbëve ndaj Kosovës dhe përgatitja e tyre për shpëputjen e mundshme të saj nga Republika serbe. Edhe popujve të tjerë në shekullin XX u është dashur të përballen me humbje të tilla të ngjashme që ata i shikonin si pjesë të pandashme të trashëgimisë së tyre kombëtare; grekët në Azinë e Vogël dhe gjermanët në Evropën Lindore, janë ndoshta shembujt më të dukshëm. Megjithatë, këto territore janë humbur si rezultat i dobësive ushtarake dhe politike të cilat nuk mund të thuhet se gjejnë zbatim për serbët e sotshëm, me gjithë vetëperceptimin e tyre se janë mashtruar. Sidoqoftë, për arsye të kuptueshme duket se ata janë të vendosur të mbajnë fort Kosovën dhe thuhet se shumë prej tyre iu përgjigjën revoltave me thëniet: “Kjo nuk do të kishte ndodhur nëse Rankoviç do të ishte ende këtu”. Duhet të kujtojmë se emri i Rankoviç është shoqëruar me shtypjen e ashpër të shqiptarëve, një qasje që gjithësi ka provuar të jetë vetëshkatërruese në analizën përfundimtare për trajtimin e pakicave kombëtare në Evropën Lindore moderne.

Në këtë situatë, shumë varet nga balanca e zgjidhjes për problemin e Kosovës, duke përfshirë ekuilibrin brenda sistemit federal të Jugosllavisë dhe stabilitetin politik të Ballkanit në tërësi, ose duke dobësuar Jugosllavinë si një element kyç ose thjesht duke ofruar më shumë ujëra të turbullta ku të peshkohen sovjetikët. Sidoqoftë, duke pasur parasysh dimensionin e faktorëve të përfshirë, duket se zgjidhja nuk është aspak e lehtë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 408/1

Dt: 21.03.2024

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit 35 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës, nenit 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Udhëzimit Administrativ 34/2014 për funksionimin e shërbimit pedagogjik dhe psikologjik në shkolla, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2015, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

Ri-SHPALLJE E KONKURSIT

Për plotësimin e vendit të lirë në Qendra e Kompetencës në "Shtjefen Gjeçovi", në Prishtinë

Niveli	Institucioni/Shkoll a	Vendi	Pozita:	Vend i lirë/ Zëvendësim	Numri i pozitave
SHML	Qendra e Kompetencës "Shtjefen Gjeçovi", në Prishtinë	Prishtinë	Mësimdhënës/e për lëndet mesimore Elektroteknikë dhe Elektronikë	Zëvendësim	1
SHML	Qendra e Kompetencës "Shtjefen Gjeçovi", në Prishtinë	Prishtinë	Psikolog/e	Vendi lirë	1

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (merret në Shkollë);
- Rezymeja personale (CV);
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë);
- Diplomat e kualifikimit, **duhet të jenë të vërtetuara ose noterizuara;**
- Certifikatat e noterizuara (certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë jo më të vjetra se gjashtë (6) muaj nga data e diplomimit;
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (**nëse ka**).

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (**Ligji Nr. 04/L-032, Ligji Nr. 04/L-138**) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHTI-it (UA Nr. 05/2015) si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

Kriteret e kualifikimit për Mësimdhënës/e për lëndet mesimore Elektroteknikë dhe elektronikë

- Msc. i elektroteknikës/elektronikës
- Inxh. i dipl. i elektroteknikës/elektronikës

III. Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (merret në Shkollë);
- Rezymeja personale (CV);
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë);
- Diplomat e kualifikimit, **duhet të jenë të vërtetuara ose noterizuara;**
- Certifikatat e noterizuara (certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë jo më të vjetra se gjashtë (6) muaj nga data e diplomimit;
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (**nëse ka**).

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (**Ligji Nr. 04/L-032, Ligji Nr. 04/L-138**) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHTI-it (UA Nr. 05/2015) si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

Kriteret e kualifikimit për Mësimdhënës/e për lëndet mesimore Elektroteknikë dhe elektronikë

- Msc. i elektroteknikës/elektronikës
- Inxh. i dipl. i elektroteknikës/elektronikës

III. Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

IV. Detyrat kryesore të punës Psikolog në shkollë;

- Të vlerësojë dhe interpretojë çështjet që kanë të bëjnë me procesin e të nxënësve dhe zhvillimin psikologjik, social dhe emocional të nxënësve;
- Të ofrojë ndihmë në tejkalimin e vështirësive të natyrës psikologjike me të gjithë akterët në shkollë;
- Të ofrojë ndihmë në identifikimin e nxënësve me vështirësi në të nxënë dhe nxënësve të talentuar;
- Të zhvillojë intervista me nxënës, mësimdhënës e prindër, vëzhgime e procedura të ndryshme, me qëllim të vlerësimit objektiv, dhe propozon e zbaton masa për intervenime psiko-edukative individuale dhe në grup;
- Të mbajë lidhjet me asistentët lidhur me nxënësit, të cilët kanë nevojë për ndihmë ose kanë probleme personale;
- T'i këshillojë nxënësit, të cilët kanë nevojë për ndihmë në mësim, punë vazhduese, këshillojë për zgjedhjen e profesionit ose të cilët kanë nevojë për këshilla për të tejkaluar problemet personale;
- Të punon me nxënës për të zhvilluar strategji efektive të të nxënësve të zhvillimit social e personal, strategji vetë monitoruese e shkathtësi tjera kognitive;
- Të zhvillojë këshillime individuale dhe/ose grupe që përqendrohen në funksionimin e shëndetshëm të nxënësve;
- Të përgatitë raporte mujore dhe vjetore për drejtorin e shkollës;
- Të angazhohet në komisionet profesionale;
- Të kryejë edhe detyra të tjera, të caktuara nga drejtori dhe ato të përcaktuara me akte të tjera normative.


V. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve;

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 04/L-032) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ MASH nr. 34/2014 për funksionimin e shërbimit pedagogjik dhe psikologjik në shkolla si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

Kriteret e kualifikimit për Psikolog/e të shkollës:

- Master në degën e Psikologjisë – drejtimi: Psikologji Shkollë dhe Këshillim të Fakultetit Filozofik (300 ECTS)

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Inveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Godbold e Bashkimit, MVP e javës së nëntë

Prizren, 21 mars - Bashkimi ka regjistruar fitoren e nëntë në nëntë ndeshje të Ligës Unike Femrat. Prizrenaset kanë shënuar fitore ndaj Tiranës. Adrienne Godbold e mbylli ndeshjen me 35 pikë, nëntë kërcime dhe katër asistime, duke e pasur indeksin e ndeshjes 44, apo më të lartin e

kësaj xhiroje, duke u shpallur MVP. Statistika të afërta kishte edhe qendra e Kosovës, Aulona Muhadri, duke e mbyllur takimin me 28 pikë, nëntë kërcime dhe katër asistime. Prishtina, po ashtu, shënoi fitore si mysafir ndaj Flamurtarit të Vlorës. Më e mira te prishtinaset ishte Jaccqueline

Castro me 14 pikë dhe dhjetë kërcime. Penza shënoi fitore ndaj Partizanit, duke siguruar një vend në "play-off". Te skuadra pejane u dalluan Saranda Daci dhe Peevy Elise. Daci kishte 20 pikë, shtatë kërcime dhe pesë asistime, kurse Elise 20 pikë, 11 kërcime dhe dy asistime.



Kosova sot përballet me Armeninë, Foda dhe Muriqi paralajmërojnë fitore

Franco Foda dhe Vedat Muriqi kanë paralajmëruar se në miqësoren ndaj Armenisë, e cila zhvillohet sot nga ora 17:00, do të luajnë për fitore. Motivi është i madh në kampin e "dardanëve", pasi është ndeshja e parë me trajnerin e ri. "Jemi përgatitur mjaft mirë për këtë ndeshje. Do të përpiqemi t'i fitojmë të gjitha ndeshjet", ka thënë Foda



për këtë ndeshje. Ne do të përpiqemi t'i fitojmë të gjitha ndeshjet", ka thënë Foda.

Në konferencë për medie ishte edhe sulmuesi Vedat Muriqi, i cili ka thënë se Kosova është favorite në këtë ndeshje dhe se luan për fitore edhe pse është veç një ndeshje miqësore. "E gjithë skuadra është përgatitur për ndeshjen fizikisht dhe psikikisht. Ndonëse janë ndeshje miqësore, është shumë e rëndësishme të fitojmë dhe të mësohemi me fitore. Besoj se Kosova është favorite për ndeshjen e nesërme. Individualisht dhe si ekip do të demonstrojmë se jemi më të mirë. E njohim ekipin e Armenisë mirë dhe e kemi analizuar", ka thënë Muriqi.

Kjo nuk është miqësorja e vetme për Kosovën në këtë muaj, pasi më 26 mars do të përballet me Hungarinë.

shumë të mirë dhe të dyja kanë paraqitje solide. Në tri ditët e fundit jemi koncentruar në aspektin taktik. Do të luajmë në mënyrë sa

më shumë agresive dhe të sulmojmë sa më shpejt. Nuk e di, nuk mund të them se kush është favorit. Jemi përgatitur mjaft mirë

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 21 MARS - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll do të luajë sot (e premte) ndeshje miqësore ndaj Armenisë në "Vazgen Sargsyan Republican Stadium" të Yerevanit nga ora 17:00. Përzgjedhësi Franco Foda ka thënë se Kosova dhe Armenia kanë lojtarë të mirë, por ka paralajmëruar se "dardanët" do të luajnë në mënyrë agresive dhe të

sulmojnë sa më shpejt. Trajneri gjerman që debutoi në krye të Kosovës më pas ka thënë se do të përpiqen t'i fitojnë të gjitha ndeshjet. "Kemi pasur seanca stërvitore shumë të mira në Prishtinë, edhe pse koha nuk ka qenë aq e përshtatshme. Sidoqoftë, ekipi është në gjendje të mirë, përpos problemeve muskulore të Rrahmanit dhe të Rashicës. Por, ata do të jenë në stërvitje sot dhe besoj edhe në ndeshjen e nesërme. Armenia dhe Kosova kanë lojtarë

Portieri Arben Beqiri braktis futbollin dhe Kosovën për një jetë më të mirë në Gjermani

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 21 MARS - Portieri i njohur në futbollin e Kosovës, Arben Beqiri, ka vendosur përfundimisht të largohet nga loja e tij e zemrës, por edhe nga vendi, për një jetë më të mirë në Gjermani. "Faleminderit KF Trepça Faleminderit kryesisht së klubit, faleminderit trajnerëve: Emin Baliqi, Shpëtim Fetahu, Enis Manxholli, Nexhat Zhubi. Faleminderit të gjithë bashkëlojtarëve për respektin e treguar ndaj meje. U jam mirënjohës gjithë jetën. Të gjithë së bashku për Trepçën", ka shkruar

Beqiri. Një prej portierëve më të mirë të gjeneratës së tij, "Beni", përveç sportist me kualitet të lartë dhe shembullor në fushën e blertë, ishte edhe person shembull në jetën e përditshme. Klubi i Trepçës në "Facebook" e ka falënderuar Beqirin për kontributin e madh, derisa ka shkruar se dyert e klubit gjithmonë do të jenë të hapura për të. "Faleminderit Arben Beqiri - 'Beni'! Pas shumë viteve në fushën e gjelbër si lojtar, por dhe si njeri shembullor, i afërt dhe bashkëpunues me të gjithë, i jashtëzakonshëm në portë, i disiplinuar dhe punëtor i pashoq,



ku para disa ditëve iu deshtë që të gjitha t'i mbesin si vepra të pashlyera duke i thënë lamtumirë

fushës se blertë, shokëve, stafit të trajnerëve, udhëheqësisë dhe mbarë komunitetit sportiv, duke e

lënë vendlindjen për një jetë më të mirë. "Beni", të faleminderit për kontributin e dhënë në klubin tënd në klubin e qytetit, që iu gjinde dhe t'u gjind në kohët më të vështira! Puna dhe paraqitjet e tua do të mbeten modele për gjeneratat e reja. Ty suksese në profesionin e ri, duke të dëshiruar shëndet dhe lumturi e dyert për një njeri si ti në klub janë gjithmonë të hapura", thuhet në postimin e skuadrës së Trepçës.

35-vjeçari ka luajtur për Trepçën, Llapin, Besën, Trepçën '89, Ulpianën dhe Vushtrrinë. Ai ka fituar dy herë Kupën e Kosovës me Trepçën '89 dhe me Besën e Pejës.

Refuzohet ankesa e Llapit, mbetet në fuqi fitorja e Malishevës

Prishtinë, 21 mars - Është hedhur poshtë ankesa e KF Llapit edhe nga shkalla e dytë e Komisionit për Ankesa për sa i përket ndeshjes ndaj Malishevës. Kjo ka bërë që të mbetet në fuqi fitorja e Malishevës prej 2-1, ndërsa në

vendimin e Komisionit për Ankesa thuhet se vendimi i komisionit të garave ka qenë i drejtë. "Komisioni për Ankesa - shkalla e dytë - vërteton se vendimi i komisionit të garave për ndeshjen e zhvilluar me datë 13.03.2024 në mes të KF

Malisheva dhe KF Llapi 1932 ka qenë i drejtë dhe se ankesa e KF Llapi 1932 hedhet poshtë", thuhet në vendim. Klubi nga Podujeva ishte ankuar se Malisheva ka inkuadruar në lojë një lojtar i cili nuk kishte të drejtë të luante, pasi kishte

përmbushur numrin e kartonëve të verdhë. Aktualisht në vendin e parë në Superligë është Ballkani me 52 pikë, Llapi në të dytin me 51 pikë, Drita në të tretin me 50 pikë, kurse vendin e katërt e zë Malisheva me 47 pikë.



Morata: Shqipëria ishte spektakolare në kualifikuese, Spanja dhe Italia kalojnë grupin

Madrid, 21 mars - Alvaro Morata ka bërë parashikimin e tij për skuadrat që kualifikohen nga Grupi B në "Euro 2024", aty ku bëjnë pjesë Italia, Spanja, Kroacia dhe Shqipëria. Ylli spanjoll ka rezervuar fjalët më të mira për kombëtaren kuqezi, duke e cilësuar "spektakolare" në

kualifikuese. "Shpresoj që Italia dhe Spanja të kualifikohen dhe më lejoni të shtoj një gjë. Ata që shkojnë përtej grupit tonë do të shkojnë shumë larg, por do të jetë e vështirë. Kroacia ka një gjen konkurrues të jashtëzakonshëm. Përfundoi në vendin e dytë dhe të tretë

në dy edicionet e fundit të Kupës së Botës. E kishim përballë edhe në Evropian, madje mund të kualifikohej. Vitin e kaluar e mundëm me penallti në Ligën e Kombeve", ka thënë Morata. "Shqipëria ishte spektakolare në fazën e grupeve kualifikuese. Problemi është se ne nuk mund të

bëjmë gabime. Nëse ul ritmin, je menjëherë nën presion. Megjithatë, kjo skuadër spanjolle ka një grup të madh, ndërkohë që Italia fitoi Evropianin falë forcës së grupit. Është shembulli që duhet ndjekur", ka shtuar sulmuesi për "Gazzetta dello sport".



Nisin punimet në stadiumin e Shtimes, synohet të përfundohen brenda një viti

Shtime, 21 mars - Punimet për zgjerimin e stadiumit të Shtimes kanë filluar të enjten. Ky projekt, i cili përfshin ndërtimin e zhyshitoreve të reja, tribunave të reja dhe të gjithë infrastrukturës përcjellëse, do të financohet nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS).

Zëvendësministria e MKRS-së, Daulina Osmani, së bashku me kryetarin e Shtimes, Qemajl Aliu, me rastin e fillimit të punimeve për zgjerimin dhe renovimin e tij, vizituan sot stadiumin e kësaj komune.

Osmani për "KosovaPress" tha se qëllimi i kësaj vizite ishte për ta parë punën e operatorit ekonomik deri tani si dhe për sigurimin e mbështetjes nga të dyja nivelet institucionale, respektivisht MKRS-ja dhe komuna Shtime. "Sot po fillojnë punimet e zgjerimit dhe renovimit të stadiumit të qytetit të Shtimes, projekt ky i përbashkët me komunën e Shtimes, i financuar nga ministria në vlerë prej 2.4 milionë eurosh. Siç po shihet, fusha aktualisht ka përjetuar një rinovim në bari, mirëpo parashihet zgjerimi i zhyshitoreve, i pjesëve përcjellëse, tribunave për tifozët", ka thënë Osmani.

Ndërkaq kryetari i Shtimes, Qemajl



Aliu, tha për "KosovaPress" se fillimi i punimeve për renovimin dhe zgjerimin e stadiumit është një ngjarje shumë e rëndësishme, investim ky që kjo komunë nuk e ka përjetuar asnjëherë.

Kryetari Aliu tha se nga e hëna do të fillojnë punimet me një dinamikë të shpejtuar, pasi që po synohet që ky projekt të finalizohet brenda vitit. "Është një ngjarje shumë e rëndësishme për komunën e Shtimes, për sportdashësit në komunën e Shtimes, por jo vetëm. Po bëhet investim që komuna e Shtimes nuk e ka përjetuar asnjëherë. Falë mbështetjes nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit sot jemi këtu bashkë me zëvendësministren për ta parë koordinimin që do të bëhet mes Klubit të Futbollit Vjosa, komunës dhe operatorit për t'i filluar punët pa humbur kohë. Ju e dini që ky projekt tashmë është finalizuar në aspektin

e përzgjedhjes së operatorit dhe sa kuptuam nga e hëna do të fillojë një punë me dinamikë të shpejtuar, me synimin që brenda një viti ky projekt të jetë i realizuar dhe të jetë në shërbim të sportdashësve dhe të futbollistëve të komunës së Shtimes, të cilët po na bëjnë krenarë me rezultatet që kanë arritur. Klub i Futbollit Vjosa është kampion vjeshtor

në Ligën e Parë, me pretendimin për të shkuar drejt Superligës. Realisht kushtet i kanë munguar klubit, por sukseset nuk i kanë munguar, kështu që unë personalisht, bashkë me zëvendësministren dhe me krejt ekipin e komunës, por edhe të ministrisë, jemi të kënaqur që këtyre sukseseve të klubit po u shkojmë mbrapa me infrastrukturë moderne të merituar", ka thënë Aliu.

Para dy javësh stadiumi i qytetit në Shtime është bërë me bar sintetik, projekt ky i cili është bashkëfinancuar nga komuna e Shtimes dhe Federata e Futbollit e Kosovës (FFK), e që kap vlerën 250 mijë euro. Ndeshjet në këtë stadium i zhvillon skuadra e Vjosës, e cila është shpallur kampione vjeshtore në Ligën e Parë të Kosovës dhe është kandidat serioze për t'u inkuadruar në futbollin elitë, respektivisht në Superligën e Kosovës.

Fitorja e shtatë radhazi për Bostonin, Oklahoma merr kreun e renditjes në Perëndim

Boston, 21 mars - Fitorja e shtatë radhazi për Bostonin, skuadra më e mirë në NBA këtë sezon, që e mposhti me rezultat 122-119 Milwaukee. Përballja mes dy ekipeve më të mira në Konferencën e Lindjes ishte mjaft e bukur, me rivalitet deri në fund. Mungesa e Antetokounmpos ndikoi te Bucks, ku u dalluan Lillardit me 32 pikë e Portisi me 24 pikë. Për Bostonin, më i miri në fushë ishte Tatum me 31 pikë, mbështetur edhe nga White me 23 pikë e Browni me 21 pikë. Rikthehet te suksesi Golden State, që mundi me shifrat 137-116 Memphisin, ndeshje ku



kolektiviteti i Warriorsit bëri diferencën në fushë, me 7 lojtarë që realizuan mbi 10 pikë. Pa probleme fitojnë edhe clippersat, që mundën me rezultat 116-103 Portlandin (Gorge 27 pikë). Në krye të renditjes në Konferencën e

REZULTATET	
Cleveland - Miami	104-107
Detroit - Indiana	103-122
Boston - Milwaukee	122-119
Toronto - Sacramento	89-123
Oklahoma - Utah Jazz	119-107
Golden State - Memphis	137-116
Phoenix - Philadelphia	115-102
Portland - Clippers	103-116

Perëndimit ndodhet Oklahoma, që mundi me shifrat 119-107 Utah Jazzin, sfidë ku u dallua Holmgren me 35 pikë. Miami, falë 30 pikëve të Jimmy Butlerit, mundi me shifrat 107-104 Clevelandin jashtë fushës në sekondat e fundit.

SHKURT

Berisha mungon ndaj Kilit

Etrit Berisha nuk do të jetë në dispozicion të trajnerit Sylvinho për ndeshjen e parë miqësore të muajit mars, atë ndaj Kilit, që luhet me datë 22 mars në Parma të Italisë. Portieri do të udhëtojë me Kombëtaren drejt Italisë këtë të enjte, megjithatë ai do të mund të luajë vetëm në ndeshjen e 25 marsit ndaj Suedisë. Berisha ka ndier një shqetësim dhe për këtë arsye është stërvitur në mënyrë të dalluar, ndërsa trajneri Sylvinho ka vendosur që në sfidën e parë të skuadrës "kuqezi" ai të pushojë. Shqipëria do të ndeshet me Kilin këtë të premte, sfidë që nis në orën 20:45 dhe që do të luhet në stadiumin "Ennio Tardini".

Robinho dënohet me nëntë vjet burgim për përdhunimin e 22 vjeçes shqiptare

Ish-sulmuesi i Real Madridit, Manchester Cityt dhe Milanit, Robinho, është dënuar me nëntë vjet burgim për rastin e përdhunimit të një 22-vjeçeje shqiptare në vitin 2013. Robinho u shpall fajtor nga një gjykatë italiane në vitin 2017 për pjesëmarrje në përdhunimin në grup të 22-vjeçes shqiptare, ndërsa vendimin për burgim prej 9 vjetësh e dha gjykata në Brasilia, pas një kërkesë nga Italia. Brazili do të mbetet në liri deri në vendimin e apelit, ndërsa në kohën e krimit Robinho luante për Milanin, shkruan BBC. Robinho fitoi dy tituj të La Ligës në katër sezone në Real Madrid përpara se t'i bashkohej Cityt për një tarifë rekorde të atëhershëm prej 32.5 milionë funtesh. Pas dy sezonesh, Robinho u transferua te Milani ku kaloi pesë vjet përpara se të transferohej në skuadrën kineze Guangzhou Evergrande dhe të kthehej në Brazil tek Atletico Mineiro.

Leclerc: Synojmë më shumë se vendi i tretë në garë

Charles Leclerc u klasifikua në vendin e tretë në garën e fundit të Formulës 1 zhvilluar në Arabinë Saudite, duke korrur podiumin e parë sezonal. Në prag të garës së Australisë, këtë fundjavë, monogasku i Ferrarit e sheh si pozitiv këtë start, me dy vende të treta nga pilotët e "kokëkuqes". "Mendoj se jemi në një pozicion më të mirë se vitin e kaluar. Kur fillimisht pilotuam me makinën e vitit të kaluar, ajo nuk performoi ashtu siç prisnim. Ndaj ishte pak e vështirë për të kuptuar se nga vinte problemi dhe e identifikuam me vonesë atë që na pengonte", u shpreh Leclerc. Ato të një viti më parë janë ndjesitë që Leclerc tani i ka lënë pas: "Sidoqoftë këtë vit, makina nuk ka asgjë të keqe. Të paktën bën gjithçka që presim, që është një pikënisje e mirë. Dhe ne mund të fokusohemi menjëherë te përmirësimi i saj, gjë që më jep besim se ritmi i zhvillimit do të jetë më i mirë se vitin e kaluar". Në Australi, Leclerc i kërkohet të kompensojë një nga garat më zhgënjyese të vitit 2023, ku pas një kontakti, që në start u tërhoq. "Red Bulli mbetet favorit edhe aty, por do të shohim nëse mund të shkojmë më lart se vendi i tretë. Besimi nuk mungon. Të shohim se si do të reagojë makina", ka thënë Leclerc.

PSG-ja, ofertë marramendëse për Mbappen

Kylian Mbappe e ka marrë një ofertë marramendëse nga Paris Saint-Germaini, në bazë të së cilës, ylli francez do të paguhej plot 6 milionë euro në muaj. Me këtë rast, 25-vjeçari do të

paguhej 72 milionë euro në vit. Lajmin e ka dhënë media franceze "L'Equipe". Me këtë rast, sulmuesi francez do të marrë para më shumë se Ousmane Dembele (€1.12M),

Marquinhos (€1.12M), Lucas Hernandez (€1.1M), Milan Skriniar (€1.1M) e Gianluigi Donnarumma (€850K), që marrin së bashku. Përfaqësuesi francez është duke i kaluar muajt

e fundit të kontratës me klubin nga "Parku i Princave" dhe është i vendosur për t'u larguar prej aty, për ta provuar një përvojë të re. Sipas të gjitha gjasave, ish-futbollisti i Monacos do të

përfundojë në Real Madrid. Sidoqoftë, sheikët arabë po mundohen ta joshin me oferta të reja në mënyrë që t'ia kthejnë mendjen dhe ta bindin që të qëndrojë në klubin parisien.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 408/1

Dt: 21.03.2024

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit 35 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës, nenit 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Udhëzimit Administrativ 34/2014 për funksionimin e shërbimit pedagogjik dhe psikologjik në shkolla, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2015, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

Ri-SHPALLJE E KONKURSIT

Për plotësimin e vendit të lirë në Qendra e Kompetencës në "Shtjefen Gjeçovi", në Prishtinë

Niveli	Institucioni/Shkoll a	Vendi	Pozita:	Vend i lirë/ Zëvendësim	Numri i pozitave
SHML	Qendra e Kompetencës "Shtjefen Gjeçovi", në Prishtinë	Prishtinë	Mësimdhënës/e për lëndet mesimore Elektroteknikë dhe Elektronikë	Zëvendësim	1
SHML	Qendra e Kompetencës "Shtjefen Gjeçovi", në Prishtinë	Prishtinë	Psikolog/e	Vendi lirë	1

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (merret në Shkollë);
- Rezymeja personale (CV);
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë);
- Diplomat e kualifikimit, **duhet të jenë të vërtetuara ose noterizuara;**
- Certifikatat e noterizuara (certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë jo më të vjetra se gjashtë (6) muaj nga data e diplomimit;
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (**nëse ka**).

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (**Ligji Nr. 04/L-032, Ligji Nr. 04/L-138**) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHTI-it (UA Nr. 05/2015) si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

Kriteret e kualifikimit për Mësimdhënës/e për lëndet mesimore Elektroteknikë dhe elektronikë

- Msc. i elektroteknikës/elektronikës
- Inxh. i dipl. i elektroteknikës/elektronikës

III. Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (merret në Shkollë);
- Rezymeja personale (CV);
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë);
- Diplomat e kualifikimit, **duhet të jenë të vërtetuara ose noterizuara;**
- Certifikatat e noterizuara (certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë jo më të vjetra se gjashtë (6) muaj nga data e diplomimit;
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (**nëse ka**).

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (**Ligji Nr. 04/L-032, Ligji Nr. 04/L-138**) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHTI-it (UA Nr. 05/2015) si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

Kriteret e kualifikimit për Mësimdhënës/e për lëndet mesimore Elektroteknikë dhe elektronikë

- Msc. i elektroteknikës/elektronikës
- Inxh. i dipl. i elektroteknikës/elektronikës

III. Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

IV. Detyrat kryesore të punës Psikolog në shkollë;

- Të vlerësojë dhe interpretojë çështjet që kanë të bëjnë me procesin e të nxënës dhe zhvillimin psikologjik, social dhe emocional të nxënësve;
- Të ofrojë ndihmë në tejkalimin e vështirësive të natyrës psikologjike me të gjithë akterët në shkollë;
- Të ofrojë ndihmë në identifikimin e nxënësve me vështirësi në të nxënë dhe nxënësve të talentuar;
- Të zhvillojë intervista me nxënës, mësimdhënës e prindër, vëzhgime e procedura të ndryshme, me qëllim të vlerësimit objektiv, dhe propozon e zbaton masa për intervenime psiko-edukative individuale dhe në grup;
- Të mbajë lidhjet me arsimtarët lidhur me nxënësit, të cilët kanë nevojë për ndihmë ose kanë probleme personale;
- T'i këshillojë nxënësit, të cilët kanë nevojë për ndihmë në mësim, punë vazhduese, këshillojë për zgjedhjen e profesionit ose të cilët kanë nevojë për këshilla për të tejkaluar problemet personale;
- Të punon me nxënës për të zhvilluar strategji efektive të të nxënës të zhvillimit social e personal, strategji vetë monitoruese e shkathtësi tjera kognitive;
- Të zhvillojë këshillime individuale dhe/ose grupe që përqendrohen në funksionimin e shëndetshëm të nxënësit;
- Të përgatitë raporte mujore dhe vjetore për drejtorin e shkollës;
- Të angazhohet në komisionet profesionale;
- Të kryej edhe detyra të tjera, të caktuara nga drejtori dhe ato të përcaktuara me akte të tjera normative.

V. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve;

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 04/L-032) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ MASH nr. 34/2014 për funksionimin e shërbimit pedagogjik dhe psikologjik në shkolla si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

Kriteret e kualifikimit për Psikolog/e të shkollës:

- Master në degën e Psikologjisë – drejtimi: Psikologji Shkollë dhe Këshillim të Fakultetit Filozofik (300 ECTS)



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Numër:394/1
 Datë: 21.03.2024

Agjencia e Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur (AAAPARr), në bazë të nenit 13 Ligjit të Arsimit dhe Aftësimin Profesional (Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 7/26 Mars), në bazë të Ligjit Nr. 04/1-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 05/2012, Udhëzimit Administrativ nr. 14/2014, Udhëzimit Administrativ nr. 02/2016, si dhe në bazë të kërkesës të dt. 29.03.2022 së shkollës Sh M L P “Qendra e Kompetencës”, në Prizren shpall:

Ftesë për ofertë

Për ekskursion të maturantëve të ShMPLP „Qendra e Kompetencës” në Prizren, në Republikën e Shqipërisë

Ftojme ofertuesit e kualifikuar (Agjencionet turistike organizatore të udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarf të mbyllur.

Agjencioni turistik duhet t'i plotësojë këto parakushte:

- Regjistrimi në regjistrin profesional të ndërmarrjeve (Certifikata e biznesit).
- Certifikata e TVSH-së.
- Të jetë i licencuar sipas procedurave ligjore.
- Dëshmia e kontrollit teknik të automjetit sipas procedurave ligjore, dhe të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës.
- Autobusët të jenë komfor dhe me klimë.
- Agjencioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendor të ngasësve të autobusit.
- Agjencioni duhet të ketë të pajisur shoferët me kompetencën profesionale (CPC)
- Certifikata e autobusit sipas Licencës “D”;
- Agjencioni duhet të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënësit dhe dëshmi (Certifikatë pune dhe diplomë të mjekut) që shoqëron nxënësit;
- Lloji i transportit (Autobus);
- Agjencioni turistik duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve;
- Agjencioni duhet të ketë një dëshmi për marveshje me hotelin ku mendon me i derguar nxënësit (**KA të klasëve të 12-ta e ka preferuar javën e katërt të muajit Prill – 4 netë e 5 ditë – 29.04.2024-03.05.2024**)
- Agjencioni duhet të prezantojë dëshmi: menynë ditore të plotë për secilën ditë të ekskursionit.
- Agjencioni turistik duhet t'i përmbahet itinerarit të cilin e ka përcaktuar Këshilli Drejtues i shkollës
- Agjencioni duhet të garantojë me dëshmi (deklaratën nën betim nga OE), se do t'i mbulojë të gjitha shpenzimet gjatë vizitave në monumentet kulturo-historike.
- Agjencioni duhet të na ofrojë siguri (deklaratë nën betim nga OE), në hotele dhe gjatë vizitave që do tu bëhen monumenteve kulturo-historike.
- Agjencioni do të ofrojë dëshmi për qarkullimin financiar nga banka për tri vitet e fundit (2021-2022-2023)
- Agjencioni duhet të ofrojë një listë me emrat e shoferëve që do të marrin pjesë në ekskursion, kategorinë e patentë shoferit, llojin e autobusit, vitin e prodhimit, numrin e ulësve dhe targat e autobusit që do të vozisin.
- Agjencioni duhet të ofrojë listën e shoferëve dhe punëtorëve të deklaruar në ATK, që do të marrin pjesë në ekskursion.
- Te gjitha dokumentet e kërkuara duhet të jenë origjinale ose fotokopje të vërtetuara!

Kushtet tjera:

- Të sigurohet pansioni i plotë. Gjatë udhëtimit nëpër qytete racioni i rregullt mund të zëvendësohet me ushqim të thatë,
- Pamvarësisht numrit të nxënësve për paralele, kujdestarët e klasave shkojnë falas në ekskursion,
- Hoteli të posedojë sallë për ballo,
- Agjencioni të merr përsipër pagesën e vizitave monumenteve kulturo historike
- Të ketë komoditet gjatë udhëtimit (autobusë me kondicioner),
- Mundësi vizite në qytetet: Tiranë, Durrësi i vjetër, Shkodër, Krugë, Berat, Vlorë etj.

Vlerësimi i ofertave:

Hapja e ofertave bëhet nga komisioni sipas UA 02/2016 në ambientet e AAAPARr në Prishtinë.

Kriter për përzgjedhjen e kompanisë turistike do të jetë oferta më e përshtatshme ekonomike:

- Çmimi më i ulët ofertues (Lartësia maximale e vendosur nga KDSH është 100 Euro)
- Lloji i Hotelit (kategoria, nr. i nxënësve nëpër dhoma etj)
- Menyja
- Numri i nxënësve që udhëtojnë falas
- Gjendja teknike e autobusëve
- Referencat

Pas vlerësimit të ofertave nga komisioni, publikimi i përfutuesit do të shpallet në tabelën e shpalljeve në hyrje të shkollës.

Aplikuesit e interesuar ofertat e veta duhet t'i paraqesin në dy zarfë (në zarfën e vogël oferta e mbyllur e futur në zarfën e madhe e cila përmban dokumentacionet e kërkuara nga shkolla). Ofertat dorëzohen në zyret e AAAPARr në Prishtinë (Rruga „Agim Ramadani” p.n. nderta MASHT-i II, në katin e tretë, në objektin përball Fakultetit Ekonomik dhe Juridik në Prishtinë)

Data e nisjes mund të ndryshojë (plus-minus nje ditë), ndërsa agjenda mund të ndërrojë varësisht nga kërkesa e udhëheqësit të ekskursionit.

Afati i paraqitjes se ofertave është shtatë ditë nga dita e shpalljes në gazetën ditore.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit të datës 15.03.2024 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, K.R.M. "Uniteti" Sh.A vendosi që më datë 22.03.2024 të shpall:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendeve të punës:

Dy (2) Vozitës të kategorisë “C” – Njësia në Mitrovicë me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeçare), me mundësi vazhdimi
 Numri i referencës: 15-03-14

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Sipas Urdhërësës së Punës drejton automjetin dhe kujdeset për rregullësin, higjienën dhe pastërtin e tij;
- Është përgjegjës për vozitje të sigurt dhe për kryerjen me kohë, efikasë dhe kualitative të shërbimeve në bartjen e mbeturinave, larjen e rrugëve etj.;
- Në rastet kur e kryen terrenin e caktuar angazhohet në pika (zona), tjera sipas urdhërësës së udhëheqësit-kryepunëtorit;
- Para daljes në teren merr Urdhërësën e Punës në të cilën evidencën punët e kryera, vërejtjet mbi pengesat dhe defektet në automjet, dhe të njejtën e kthen te dispeçeri;
- Vendos (monton) letren e re të tahograftit ndërsa letren paraprake e kthen te dispeçeri, brenda 12 orëve;
- Vozitësi i cili e monton letren e tahograftit ka obligim që në të shenon: Emrin e tij, numrin e regjistrimit të automjetit, datën dhe kilometrazhën fillestare dhe përfundimtare;
- Është i obliguar që në automjet të ketë mjetet e nevojshme të punës (lopatat, fshisat etj.), për ekipën e punëtorëve me të cilët punon, largon (bartë) shtazët e ngordhura dhe i evidenton në urdhërësën e punës;
- Në rast nevojë ndrron gomat e automjetit në teren, apo në punëtorinë e mirëmbajtjes në bashkëpunim me gomistërin;
- Është i obliguar që prishjet në automjet me kohë t'i lajmron me shkrim te udhëheqësi i drejtpërdrejt dhe në punëtorinë e mirëmbajtjes;
- Çdo sjellje të pandërgjegjshme të punëtorëve me të cilët punon vozitësi është i obliguar që ta paraqet te udhëheqësi drejtpërdrejt;
- Kryepunëtori e njofton kryepunëtorin për kontejnerët e dëmtuar dhe sipas kërkesës së tij, bënë bartjen e tyre në punëtorinë e mirëmbajtjes për riparim;
- Është i obliguar që në Deponi të mbeturinave tu përmbahet rregullave dhe obligimeve të parapara në lidhje me procesin e punës në Deponi;
- Nëse automjeti me të cilin punon ndodhet në prishje apo jashtë planit momental për përdorim, është i obliguar që të drejton automjetin tjetër, dhe të kryen punë tjera sipas urdhërësës së udhëheqësit, të drejtpërdrejt nevojës së procesit të punës dhe interesit të ndërmarrjeve.

Kualifikimet

- Të ketë diplomën e shkollës mesme
- Vozitës i kategorisë “C”
- Të prezantoj leternjoftimin
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës).

Kushtet e veçanta:

Punëtori 6 (gjashtë) muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do të vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës.

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat, etj. mund të dorëzohen në Zyren e Arkivës në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave “Uniteti” Sh.A. Mitrovicë.

Konkursi do të jetë i hapur pesëmbëdhjetë (15)ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 22.03.2024 deri më datën 05.04.2024. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit të datës 15.03.2024 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, KRM "Uniteti" SH.A vendosi që më datë 22.03.2024 të shpall:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendit të punës:

Tre (3) Punëtor Fizik -Njësia në Mitrovicë me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeçare), me mundësi vazhdimi
 Numri i referencës: 15-03-15

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Kryen të gjitha punët në mblidhjen dhe ngarkimin e mbeturinave në automjete – kamion kompaktor dhe traktor;
- Zbrazen e konteinerëve dhe pastrimin e lokacionit rreth tyre nga zona e shërbimit gjerë në deponi;
- Kryen pastrimin, larjen dhe spërkatjen e sipërfaqeve publike, rrugëve dhe shesheve;
- Kryen punët e grumbullimit të mbeturinave në konteiner, kryen punët rreth pastrimit të borës, hedhjes së kripës industriale, heqjen e akullit;
- Është i obliguar të ketë sjellje korrekte ndaj qytetarëve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve;
- Është përgjegjës për përdorim të kujdesshëm të konteinerëve gjatë punës, kryen edhe punë tjera të natyrës së ngjajshme të cilat i cakton udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë.

Kualifikimet e kërkuara:

- Diploma e shkollës fillore ose të mesme e preferueshme;
- Të prezantoj leternjoftimin;
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës).

Kushtet e veçanta:

Punëtori gjashtë (6) muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do të vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës.

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj. mund të dorëzohen në Zyren e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave “Uniteti” Sh.A. Mitrovicë.
 Konkursi do të jetë i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 22.03.2024 deri më datën 05.04.2024. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Furrë Buke ANDI” SH.P.K. me seli në Vushtrri, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811955329 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Furrë Buke ANDI” D.O.O. Vushtrri, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811955329 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Furrë Buke ANDI” L.L.C. with headquarters Vushtrri, has come to the decision to quit its business: 811955329 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “FWM Client Contact” L.L.C. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812031144 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “FWM Client Contact” L.L.C. Prishtinë, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812031144 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “FWM Client Contact” L.L.C. with headquarters Prishtinë, has come to the decision to quit its business: 812031144 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, “Tek – Odak” Sh.p.k. – Mamushë, Prizrenë bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Shfrytëzimin e Argjilës në Gulibradë, Komuna Mamushë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 17.05.2024 në ora 10:00 në sallën e kuvendit komunal të Mamushës, do të organizohet debat publik nga Kompania “Tek – Odak” Sh.p.k. – Mamushë, Prizrenë bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=b252S1MvQmphd1o3bW8vckxadVorQT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Tek – Odak” Sh.p.k. – Mamushë, Prizren për Shfrytëzimin e Argjilës në Gulibradë, Komuna Mamushë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnk.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Albrim Ajdini shpall te pavlefshme diplomën Q.K “11 Marsi” Prizren.

Elmi Muqaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I – VIII shfmu “Pjeter Budi” Lubizhdë Has.

Samir Ahmetaj shpall te pavlefshme 4 dëftesa dhe diplomën Q.K. “11 Marsi” Prizren.

Nipoll Gojani nga Novosella e Ulët KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.1-5 të sh.f.m.u. “Engjëll Gjoni” Novosellë e Ulët.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

